

Kushtetuta e Zvicrës

*Përkthim jozyrtar.

Kushtetuta federale e Konfederatës Zvicerane

e datës 18 Prill 1999 (Versioni i datës Janar 2018)

Preambula

Në emër të Zotit të Plotëfuqishëm!
Populli dhe Kantonet zvicerane,
të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre drejt Krijimit,
zgjedhën t'a ripërtërijnë aleancën e tyre, për t'a forcuar lirinë, demokracinë, pavarësinë
dhe paqen në frymën e solidaritetit dhe hapjes ndaj botës,
të vendosur të jetojnë së bashku duke respektuar dallimet në mes tyre duke respektuar njëri tjetrin,
të vetëdijshëm për arritjet e përbashkëta dhe përgjegjësinë e tyre ndaj gjeneratave të reja,
duke e ditur se vetëm ata që e shfrytëzojnë lirinë e tyre do të jenë të lirë dhe se që
forca e popullit matet me mirëqenien e anëtarëve të saj më të dobët,
miratojnë këtë Kushtetutë¹:

Titulli 1 Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Konfederata zvicerane

Populli zviceran dhe Kantonet Zyrih, Bernë, Lucern, Uri, Shvic, Obwald, Nidwald, Glaris, Cug, Friburg, Soloturn, Bazel-qytetet dhe Bazel-rrethinë, Shafhousen, Apenzel i Jashtëm dhe Apenzel i Brendshëm, St. Gallen, Grison, Argau, Turgau, Tiçino, Vaud, Valis, Neuchatel, Gjenevë dhe Jura formojnë Konfederatën Zvicerane.

Neni 2 Qëllimi

¹ Konfederata zvicerane do të mbroj liritë dhe të drejtat e popullit dhe do të ruaj pavarësinë dhe sigurinë e vendit.

² Ajo do të promovoj një mirëqenje të përbashkët, zhvillim të qëndrueshëm, kohezion të brendshëm dhe diversitetin kulturor të vendit.

³ Ajo do të siguroj barazinë më të madhe të mundshme midis qytetarëve të saj.

⁴ Ajo angazhohet për një ruajtje afatgjate të resurseve natyrore dhe të një rendi botëror të drejtë dhe paqësor.

¹ RO 1999 2556

Pranuar me votim popullor të dates 12 prill 1998, në fuqi nga 1 janari 2000 (Dekreti Federal i dates 18 dhjetor 1998, Dekreti i Këshillit Federal 11 gusht 1999; RO 1999 2556; FF 1997 I 1, 1999 176 5306).

Neni 3 Kantonet

Kantonet janë sovrane për atë sa sovraniteti i tyre nuk është i kufizuar nga Kushtetuta federale dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat që nuk i janë dhënë Konfederatës.

Neni 4 Gjuhët kombëtare

Gjuhë kombëtare janë gjuha gjermane, gjuha frënge, gjuha italiane dhe gjuha romanshe.

Neni 5 Sundimi i ligjit

¹ Të gjitha aktivitetet e shtetit janë të bazuara dhe të kufizuara me ligj.

² Të gjitha aktivitetet e shtetit do të ndermerren në të mirë të interesit publik dhe të jenë në përpjestim me qëllimin e synuar.

³ Organet shtetërore dhe individët duhet të veprojnë me mirëbesim.

⁴ Konfederata dhe Kantonet do të respektojnë të drejtën ndërkombëtare.

Neni 5a² Parimi i subsidiaritetit

Parimi i subsidiaritetit duhet të respektohet në delegimin dhe përmbushjen e detyrave shtetërore.

Neni 6 Përgjegjësia individuale dhe sociale

Të gjithë individët duhet të marrin përgjegjësi për vetën e tyre dhe sipas mundësive të tyre të kontribuojnë në përmbushjen e detyrave të shtetit dhe shoqërisë.

Titulli 2 Të drejtat themelore, shtetësia dhe qëllimet shoqërore**Kapitulli 1** Të drejtat themelore**Neni 7** Dinjiteti njerëzor

Dinjiteti njerëzor duhet të respektohet dhe të mbrohet.

Neni 8 Barazia

¹ Të gjithë individët janë të barabartë para ligjit.

² Askush nuk mund të diskriminohet, veçanërisht në bazë të prejardhjes, racës, gjinisë, moshës, gjuhës, pozitës sociale, stilit të jetesës, bindjeve fetare, filozofike apo politike apo në bazë të paaftësive mendore apo fizike.

³ Burri dhe gruaja janë të barabartë para ligjit. Ligji duhet t'a rregulloj barazinë e tyre dhe t'a zbaton, veçanërisht në familje, arsimim dhe në vendin e punës. Burri dhe gruaja kanë të drejtë në kompenzim të njëjtë për punën e njëjtë.

⁴ Ligji do të parashoh masa që do të eliminojnë pabarazinë kundrejt personave me aftësi të kufizuara.

² Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i datës 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

Neni 9 Mbrojtja kundër vendimeve arbitrare dhe mirëbesimi
Çdokush ka të drejtë në trajtim jo-arbitrar dhe me mirëbesim nga organet shtetërore.

Neni 10 E drejta në jetë dhe në lirinë personale

¹ Çdo person gëzon të drejtën në jetë. Dënimi me vdekje është i ndaluar.

² Çdo person ka të drejtë në liritë personale, veçanërisht në integritetin fizik dhe mendor dhe në lirinë e lëvizjes.

³ Tortura dhe të gjitha trajtimet tjera apo dënimet mizore, jonjerëzore apo degraduese janë të ndaluara.

Neni 11 Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjëve

¹ Fëmijët dhe të rinjët kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë të integritetit të tyre dhe të inkurajimit për zhillimit të tyre.

² Ata ushtrojnë personalisht të drejtat e tyre deri në atë masë sa janë të aftë të gjykojnë.

Neni 12 E drejta në ndihmë në situata të vështira

Çdokush që ndodhet në një situatë të vështirë dhe nuk mund t'i plotësoj nevojat e veta ka të drejtë në ndihmë dhe kujdesje si dhe mjete themelore për të bërë një jetë të dinjitetshme njerëzore.

Neni 13 E drejta në privatësi

¹ Çdokush ka të drejtë në respektimin e jetës së tij private dhe familjare, në shtëpinë e tij, dhe në komunikimit me postë dhe telekomunikim.

² Çdokush ka të drejtë të mbrohet nga keqpërdorimi i të dhënave personale.

Neni 14 E drejta në martesë dhe familje

E drejta në martesë dhe familje është e garantuar.

Neni 15 Liria e besimit dhe ndërgjegjes

¹ Liria e besimit dhe ndërgjegjes është e garantuar.

² Çdokush ka të drejtë të zgjedh lirshëm besimin dhe bindjet e tij filozofike dhe t'i ushtroj vetë apo në komunitet me të tjerët.

³ Çdokush ka të drejtë t'i bashkohet ose t'i takoj një komuniteti besimtar dhe të vijoj një arsimim fetar.

⁴ Askush nuk mund të detyrohet që t'i bashkohet ose t'i takoj një komuniteti fetar, të kryej një ritual fetar ose të vijoj një arsimim fetar.

Neni 16 Liria e shprehjes dhe e informimit

¹ Liria e shprehjes dhe e informimit janë të garantuara.

² Çdokush ka të drejtë që lirisht të formoj, shpreh dhe të përhap mendimin e tij.

³ Çdokush ka të drejtë që lirisht të marr informacione nga burime të qasshme për publikun dhe t'i shpërndajë ato.

Neni 17 Liria e medieve

¹ Liria e shtypit, radios dhe televizionit, dhe e formave tjera të përhapjes së informacionit përmes mjeteve të telekomunikimit publik është e garantuar.

² Censura është e ndaluar.

³ Mbrojtja e burimit të informacionit është e garantuar.

Neni 18 Liria e përdorimit të gjuhës

E drejta e përdorimit të cilesdo gjuhë është e garantuar.

Neni 19 E drejta e shkollimit themelor

E drejta në një shkollim të mjaftueshëm themelor është papagesë dhe e garantuar.

Neni 20 Liria akademike

E drejta në hulumtim shkencor dhe mësimdhënie është e garantuar.

Neni 21 Liria e krijimtarisë artistike

Liria e krijimtarisë artistike është e garantuar.

Neni 22 Liria e tubimit

¹ Liria e tubimit është e garantuar.

² Çdokush ka të drejtë të organizoj tubime, të marrë ose të mos marr pjesë në to.

Neni 23 Liria e asociimit

¹ Liria e asociimit është e garantuar.

² Çdokush ka të drejtë të krijoj organizata, t'i bashkohet ose t'i takoj dhe të marr pjesë në aktivitetet e ndonjë organizate.

³ Askush nuk mund të detyrohet që t'i bashkohet ose t'i takoj një organizate.

Neni 24 Liria në vendbanim

¹ Qytetarët zviceranë kanë të drejtë që të zgjedhin vendbanimin kudo brenda vendit.

² Ata kanë të drejtë të lëshojnë vendin dhe prap të kthehen.

Neni 25 Mbrojtja kundër dëbimit, ekstradimit dhe deportimit

¹ Qytetarët zviceranë nuk mund të dëbohen nga vendi dhe nuk mund t'i dorëzohen një autoriteti të huaj pa pëlqimin e tyre.

² Refugjatët nuk mund të dëbohen në shtetin në të cilin ata persekutohen apo t'i dorëzohen autoriteteve të një shteti të tillë.

³ Askush nuk mund të dëbohet në territorin e një shteti në të cilin rrezikon t'i nënshtrohet torturës ose ndonjë trajtimi ose denimi tjetër mizor dhe jonjerëzor.

Neni 26 Garantimi i pronës

¹ Prona është e garantuar.

² Kompenzimi i plotë do të bëhet në rast të ekspropriimit ose në rast të ndonjë kufizimi të drejtës së pronësisë që është ekuivalent me ekspropriimin.

Neni 27 Liria ekonomike

¹ Liria ekonomike është e garantuar.

² Liria ekonomike nënkupton në veçanti lirinë e zgjedhjes së profesionit si dhe lirinë për të ushtruar ndonjë aktivitet ekonomik fitimprurës.

Neni 28 Liria e sindikatave

¹ Punëtorët, punëdhënësit dhe organizatat e tyre kanë të drejtë të organizohen me qëllim të mbrojtjes e interesave të tyre, të krijojnë sindikata, t'i bashkohen ose të mos i bashkohen ndonjë sindikate.

² Për aq sa është e mundur, konfliktet do të zgjidhen përmes negociatave dhe ndërmjetësimit.

³ Grevat dhe lock-out janë të lejuara kur kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës dhe janë në pajtim me detyrimet ruajtjes së paqes në punë dhe i shërbejnë pajtimit.

⁴ Ligji mund të ndaloj të drejtën e pjesëmarrjes në grevë një kategorie të caktuar të personave.

Neni 29 Garancitë e përgjithshme procedurale

¹ Çdokush ka të drejtë që rasti i tij të trajtohet barabartë në procedurë gjyqësore ose administrative dhe të vendoset në një afat të arsyeshëm.

² Secila palë ka të drejtën e dëgjimit.

³ Çdokush që nuk ka burime të mjaftueshme, ka të drejtë në ndihmë ligjore pa pagesë, përveç në rastet kur duket qartë se rasti i tij nuk ka asnjë mundësi të rezultoj i suksesshëm. Nëse është e domosdoshme, pala ka të drejtë në ndihmë ligjore pa pagesë në mënyrë që t'i mbrohen të drejtat e saj.

Neni 29^a Garancia e qasjes në gjykata

Çdokush ka të drejtë që qështja e tij të vendoset nga një autoritet gjyqësor. Konfederata dhe Kantonet me ligj mund të përjashtojnë qasjen në gjykatë në raste të jashtëzakonshme.

Neni 30 Garantimi i procedurës gjyqësore

¹ Çdokush rasti i të cilit gjykohet në një procedurë gjyqësore, ka të drejtë që rasti i tij të vendoset nga një gjykatë e themeluar me ligj, që ka kompetencë dhe është e pavarur dhe e paanshme. Gjykatat e jashtëzakonshme janë të ndaluara.

² Personi i paditur me padi civile ka të drejtë që rasti i tij të vendoset nga një gjykatë në vendbanimin e tij. Ligji mund të parashoh një gjykatë tjetër kompetente.

³ Përveç në rastet kur me ligj parashihet ndryshe, seancat dhe shpallja e vendimeve janë publike.

³ Pranuar me votim popullor të datës 12 mars 2000, hyn në fuqi nga data 1 janar 2007 (Dekreti Federal i datës 8 tetor 1999, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2000; DF i datës 8 mars 2005; RO 2002 3148; 2006 1059, FF 1997 I, 1999 7831; 2000 2814, 2001 4000).

Neni 31 Privimi nga liria

- ¹ Askush nuk mund të privohet nga liria përveç në rastet dhe formën e parashikuar me ligj.
- ² Çdokush i cili privohet nga liria ka të drejtë që pa vonesë dhe në një gjuhë të cilën e kupton, të informohet për arsyet e arrestimit dhe të drejtat e tij. Personave të arrestuar duhet t'u jepet mundësia e ushtrimit të të drejtave të tyre dhe sidomos të drejtës së informimit të afërmve të tyre.
- ³ Çdo i arrestuar ka të drejtë që në një afat sa më shkurtër të sillet para gjykatës e cila vendos për vazhdimin arrestit apo lirimit të tij. Çdokush ka të drejtë në një gjykim sa më të shpejtë.
- ⁴ Çdo i arrestuar pa urdhër të lëshuar nga gjykata, ka të drejtë që rasti i tij të zgjidhet nga një gjykatë. Gjykata do të vendos sa më shpejtë që është e mundur lidhur me ligjshmërinë e arrestimit.

Neni 32 Procedura penale

- ¹ Çdo i akuzuar, prezumohet i pafajshëm derisa të jetë dënuar me një vendim të formës së prerë.
- ² Çdo i akuzuar ka të drejtë që të informohet në një afat kohor sa më të shkurtër dhe në hollësi lidhur me akuzat kundër tij. Ata duhet njoftohen për të drejtën e tyre në mbrojtje ligjore.
- ³ Çdokush i dënuar ka të drejtë që gjykimi i tij të rishikohet nga një gjykatë e shkallës më të lartë. Përjashtim kanë rastet të cilat gjykohen nga Gjykata Supreme Federale si shkallë e vetme.

Neni 33 E drejta e peticionit

- ¹ Çdokush ka të drejtë dhe pa paragjykim t'i paraqes parashtesa autoriteteve.
- ² Autoritetet duhet të njoftojnë parashtruesin për pranimin e parashtesave.

Neni 34 Të drejtat politike

- ¹ Të drejtat politike janë të garantuara.
- ² Garantimi i të drejtave politike mbronë të drejtën e qytetarëve në formulim të lirë të mendimit të dhe shprehjes së tij.

Neni 35 Respektimi i të drejtave themelore

- ¹ Të drejtat themelore duhet të respektohen nga i tërë sistemi juridik.
- ² Kushdo që vepron në emër të organit shtetëror është i obliguar që të respektoj të drejtat themelore dhe të kontribuoj në realizimin e tyre.
- ³ Autoritetet, për aq sa është e mundur, kujdesen që të drejtat themelore të respektohen edhe në marrëdhëniet në mes të personave fizik.

Neni 36 Kufizimi i të drejtave themelore

- ¹ Çdo kufizim i të drejtave themelore duhet të ketë bazë ligjore. Kufizimet e rëndësishme duhet të parashihen me ligj të veçantë. Rastet e rrezikut serioz, të drejtëpërdrejtë dhe të menjëhershëm bëjnë përjashtim.
- ² Çdo kufizim i një të drejte themelore duhet të arsyetohet me interesin publik ose me mbrojtjen e një të drejtë themelore të një personi tjetër.
- ³ Çdo kufizim i të drejtave themelore duhet të jetë në proporcion me qëllimin.
- ⁴ Thelbi i të drejtave themelore është i pacenueshëm.

Kapitulli 2 Shtetësia, dhe të drejtat politike

Neni 37 Shtetësia

¹ Çdokush që është qytetar i një Komune dhe i një Kantoni është qytetar i Zvicrës.

² Askush nuk duhet privilegjohet apo të diskriminohet për shkak të shtetësisë që posedon. Kanë përjashtim rastet lidhur me rregulloret mbi të drejtat politike të qytetarëve, korporatat si dhe pasuritë e tyre, përveç nëse legjislacioni kantonal parasheh ndryshe.

Neni 38 Fitimi dhe humbja e shtetësisë

¹ Konfederata do të rregulloj fitimin dhe humbjen e shtetësisë me lindje, martesë ose birësim. Ajo gjithashtu do të rregulloj, humbjen e shtetësisë për arsye tjera si dhe rifitimin e saj.

² Ajo do të përcaktoj kushtet minimale lidhur me natyralizimin e personave të huaj nga Kantonet dhe do të jap lejen për natyralizim.

³ Ajo do të lehtësoj natyralizimin:

- a. e emigrantëve të gjeneratës së tretë;
- b. e fëmijëve pa shtetësi⁴.

Neni 39 Ushtrimi i të drejtave politike

¹ Konfederata do të rregulloj ushtrimin e të drejtave politike në nivel federal kurse Kantonet rregullojnë këto të drejta në nivel kantonal dhe komunal.

² Të drejtat politike ushtrohen në vendin e banimit. Konfederata dhe Kantonet mund të bëjnë përjashtime nga ky rregull.

³ Askush nuk mund t'i ushtroj këto të drejta në më shumë se një Kanton.

⁴ Kantonet mund të parshohin që banorët e rinjë të mos ushtrojnë të drejtën e votës në nivel kantonal dhe komunal për një periudhë deri në tre muaj pas vendosjes së tyre në vendbanimin e ri.

Neni 40 Qytetarët e Zvicrës jashtë vendit

¹ Konfederata do të kontribuoj në vendosjen e komunikimit në mes qytetarëve të saj të cilët jetojnë jashtë Zvicrës. Ajo mund të mbështesë organizatat që kanë këtë qëllim.

² Ajo do të rregulloj me dispozita çështjet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve të saj që jetojnë jashtë vendit, veçanërisht në ushtrimin e të drejtave politike në nivel federal, përmbushjen e shërbimit ushtarak ose zëvendësimin e tij, ndihmën për personat në nevojë dhe sigurimet sociale.

Kapitulli 3 Qëllimet sociale

Neni 41

1 Konfederata dhe Kantonet do të angazhohen që përveç pegjegjësive individuale dhe të iniciativës private, të sigurojnë që:

- a. çdokush të ketë qasje në sigurimet sociale;

⁴ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2017 (Dekreti Federal i datës 30 shtator 2016, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 prill 2017; RO 2017 2643; FF 2015 739 1253; 2017 3213).

- b. çdokush të ketë qasje në kujdesin shëndetësor;
- c. familja si bashkim i të rriturve dhe i fëmijëve të mbrohet dhe të inkurajohet;
- d. çdokush që është i aftë për punë të siguroj mbijetesën e tij nga një punë që e kryen në kushte të barabarta;
- e. çdokush që është në kërkim të një banese për veten dhe familjen e tij, të gjejë një banesë të përshtatshme dhe me kushte të përballueshme;
- f. fëmijët, të rinjët si dhe personat e aftë për punë të përfitojnë një arsimim fillestar dhe edukim të vazhdueshëm i cili korresdoton me aftësitë e tyre;
- g. fëmijët dhe të rinjët të inkurajohen që të pavarësohen dhe të bëhen persona socialisht të përgjegjshëm si dhe të përkrahen në integrimin e tyre social, kulturor dhe politik.

² Konfederata dhe Kantonet do të angazhohen që çdokush të jetë i mbrojtur nga pasojat ekonomike për shkak të pleqërisë, invaliditetit, sëmundjes, aksidentit, papunësisë, lindjes së fëmijës, të qenit jetim apo i ve.

³ Ato do të angazhohen në realizimin e këtyre qëllimeve sociale në kuadër të kompetencave të tyre kushtetuese dhe mundësive që kanë në dispozicion.

⁴ Asnjë e drejtë subjektive për përfitimet e shtetit nuk mund të nxirret drejtëpërdrejtë nga këto qëllimet sociale.

Titulli 3 Konfederata, Kantonet dhe Komunat

Kapitulli 1 Marrëdhëniet në mes të Konderatës dhe Kantoneve

Seksioni 1 Detyrat e Konfederatës dhe Kantoneve

Neni 42 Detyrat e Konfederatës

¹ Konfederata do të përmbush detyrat që i janë dhënë me Kushtetutë.

² ...⁵

Neni 43 Detyrat e Kantoneve

Kantonet do të përcaktojnë detyrat e tyre të cilat janë në kuadër të kompetencave të tyre.

Neni 43^a Parimet e zbatueshme gjatë ndarjes dhe përmbushjes së detyrave shtetërore

¹ Konfederata bartë vetëm ato detyra të cilat janë jashtë mundësive të Kantoneve apo kur është i nevojshëm një rregullim uniform nga Konfederata.

² Çdo trup kolektiv që përfiton nga një shërbim publik, do të bartë shpenzimet e këtij shërbimi.

³ Çdo trup kolektiv që bartë shpenzimet e këtij shërbimi vendos për natyrën e tij.

⁵ Shfuqizuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, me efekt nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i datës 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035, **2005** 883).

⁶ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

⁴ Shërbimet bazë duhet të jenë të qasshme për të gjithë në një masë të krahasueshme.

⁵ Shërbimet publike duhet të kryhen në mënyrë racionale dhe adekuate.

Seksioni 2 Bashkëpunimi në mes të Konfederatës dhe Kantoneve

Neni 44 Parimet

¹ Konfederata dhe Kantonet do të ndihmojnë njëra tjetrën në përmbushjen e detyrave të tyre dhe do të bashkëpunojnë mes vete.

² Ato i detyrohen njëta tjetrës me respekt dhe asistencë. Ato detyrohen për ndihmë reciproke administrative dhe asistencë të ndërsjelltë ligjore.

³ Kontestet ndërmjet Kantoneve si dhe ato në mes të Konfederatës dhe Kantoneve, për aq sa është e mundur do të zgjidhen përmes negocimit dhe pajtimit.

Neni 45 Pjesëmarrja në vendimmarrjen federale

¹ Në rastet e parashikuara me Kushtetutën federale, Kantonet do të marrin pjesë në vendim-marrje në rrafshin federal dhe në veçanti në shqyrtimin e legjislacionit.

² Konfederata do të njoftoj Kantonet brenda një kohe sa më të shkurtër lidhur me projektet e saj dhe atë në mënyrë të hollësishme. Ajo do t'i konsultoj ato kur interesat e tyre preken.

Neni 46 Zbatimi i së drejtës federale

¹ Kantonet do të zbatojnë ligjet federale në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet federale.

² Konfederata dhe Kantonet së bashku mund të pajtohen mbi objektivat që Kantonet duhet t'i arrijnë gjatë zbatimit të së drejtës federale. Për këtë qëllim, ato mund të zbatojnë programe që do të mbështeten financiarisht nga Konfederata⁷.

³ Konfederata do t'u lejoj Kantoneve hapsirë të madhe veprimi lidhur me organizimin e çështjeve kantonale duke marrë parasysh veçoritë e tyre⁸.

Neni 47 Autonomia e Kantoneve

¹ Konfederata do të respektoj autonominë e Kantoneve.

² Ajo do t'i lërë Kantoneve detyra të mjaftueshme dhe do të respektoj autonominë e organizimit të tyre. Ajo do t'i lejoj burime të nevojshme financiare dhe do të kontribuoj për t'u siguruar që ato të përmbushin detyrat e tyre⁹.

⁷ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

⁸ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

⁹ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

Neni 48 Marrëveshjet ndër-kantonale

¹ Kantonet mund të lidhin marrëveshje në mes tyre dhe të krijojnë institucione të përbashkëta. Së bashku ato mund të kryejnë detyra veçanërosht më interes rajonal.

² Konfederata mund të jetë pjesë e tyre brenda kompetencave të veta.

³ Marrëveshjet ndër-kantonale nuk duhet të jenë në kundërshtim me të drejtën apo interesat e Konfederatës, as në kundërshtim me të drejtat e Kantoneve tjera. Konfederata duhet të njoftohet për marrëveshjet e tilla.

⁴ Kantonet me marrëveshje mund të autorizojnë organe ndër-kantonale për të nxjerrë dispozita ligjore për të zbatuar një marrëveshje ndër-kantonale me kusht që:

- a. të jetë aprovuar sipas procedurës së njëjtë legislative me ligjet tjera;
- b. përcakton përmbajtjen bazike të dispozitave¹⁰.

⁵ Kantonet do të respektojnë ligjet ndër kantonale¹¹.

Neni 48a¹² Deklarimi i zbatimit të përgjithshëm dhe kriteret e pjesëmarrjes

¹ Me kërkesë të Kantoneve të interesuara, Konfederata mund të deklaroj marrëveshjet ndër-kantonale të detyrueshme për të gjithë apo të detyroj ndonjë Kanton tjetër të aderoj në marrëveshjet ndër-kantonale në fushat si në vijim:

- a. ekzekutimi i dënimeve dhe masave tjera;
- b.¹³ shkollimi sipas dispozitave të Nenit 62, paragrafi 4;
- c.¹⁴ shkollat e larta kantonale;
- d. institucionet kulturore të rëndësisë mbi-regjionale;
- e. menaxhimi i mbeturinave;
- f. trajtimi i ujrave të përdorshme;
- g. transporti urban;
- h. mjekësia e avancuar dhe klinikat e specializuara;
- i. institucionet e rehabilitimit dhe kujdesit ndaj personave me aftësi të kufizuara.

² Deklarimi i zbatimit të përgjithshëm bëhet me dekret federal.

³ Ligji do të përcaktoj kushtet për deklarimin e zbatimit të përgjithshëm dhe detyrimin për të aderuar në to si dhe do të rregulloj procedurat.

¹⁰ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

¹¹ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

¹² Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

¹³ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 djeter 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO **2006** 3033; FF **2005** 5159 5225 6793, **2006** 6391).

¹⁴ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 djeter 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO **2006** 3033; FF **2005** 5159 5225 6793, **2006** 6391).

Neni 49 Epërsia dhe respektimi i së drejtës federale

¹ E drejta federale ka epërsi ndaj të drejtës kantonale e cila është në kundërshtim me të.

² Konfederata do të kujdeset që Kantonet të respektojnë të drejtën federale.

Seksioni 3 Komunat

Neni 50

¹ Autonomia komunale është e garantuar brenda kufijve të së drejtës kantonale.

² Konfederata do të ketë parasysh pasojat eventuale të aktiviteteve të saj për Komunat.

³ Duke vepruar kështu, ajo do të marr parasysh situatat e vaçanta të qyteteve, zonave urbane, dhe zonave malore.

Seksioni 4 Garancitë federale

Neni 51 Kushtetutat kantonale

¹ Çdo Kanton do të miratojë një kushtetutë demokratike. Ajo duhet të pranohet nga Populli dhe do të mund të rishikohet nëse shumica e trupit elektoral e kërkon.

² Kushtetutat kantonale duhet të garantohen nga Konfederata. Ajo garantohet nëse nuk është në kundërshtim me të drejtën federale.

Neni 52 Rendi kushtetues

¹ Konfederata do të mbrojë rendin kushtetutes të Kantoneve.

² Ajo do të intervenoj kur rendi publik në një Kanton është rrezikuar dhe Kantoni nuk është në gjendje t'a bëjë këtë i vetëm apo me ndihmen e Kantoneve tjera.

Neni 53 Ekzistenca, statusi dhe territori i Kantoneve

¹ Konfederata do të mbrojë ekzistencën, statusin dhe territorin e Kantoneve.

² Çdo ndryshim i numrit të Kantoneve apo statutit të tyre kërkon miratimin e trupit të tij elektoral dhe të Kantoneve përkatëse si dhe votimin nga Populli dhe Kantonet së bashku.

³ Çdo ndryshim i territorit të një Kantoni është subjekt i miratohet nga trupi i tij elektoral dhe i Kantoneve përkatëse; ai pastaj duhet të miratohet nga Asambleja Federale në formë të dekretit federal.

⁴ Ndryshimi i kufijve kantonale bëhet me një marrëveshje ndërmjet Kantoneve në përkatëse.

Kapitulli 2 Kompetencat**Seksioni 1 Marrëdhëniet me jashtë****Neni 54** Marrëdhëniet me jashtë

¹ Marrëdhëniet me jashtë janë përgjegjësi e Konfederatës.

² Konfederata do të angazhohet për ruajtjen e pavarësisë dhe prosperitetit të Zvicrës; ajo do të kontribuoj në veçanti në nihmën për personat në nevojë, zbutjen e varfërisë si dhe promovimin e respektimit të drejtave të njeriut, demokracisë, bashkëjetesën paqësore ndërmjet popujve dhe ruajtjen e burimeve natyrore.

³ Ajo do të respektoj kompetencat e Kantoneve dhe do të mbrojtë interesat e tyre.

Neni 55 Pjesëmarrja e Kantoneve në vendimet e politikës së jashtme

¹ Kantonet do të konsultohen për vendimet e politikës së jashtme që kanë ndikim në kompetencat dhe interesat e tyre thelbësore.

² Konfederata do të informoj Kantonet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në mënyrë të hollësishme si dhe konsulton ato.

³ Pikëpamjet e Kantoneve janë të një rëndësie të veçantë kur interesat e tyre janë të prekura. Në këto raste, Kantonet në formë të përshtatshme marrin pjesë në negociata ndërkombëtare.

Neni 56 Marrëdhëniet e Kantonetve me jashtë

¹ Kantonet mund të lidhin marrëveshje me shtete të jashtme për çështjet që janë kompetencë e tyre.

² Këto marrëveshje nuk duhet të jenë në kundërshtim me të drejtën dhe interesat e Konfederatës, apo në kundërshtim me të drejtën e Kantonetve tjera. Përpara se të lidhet një marrëveshje, Konfederata duhet të njoftohet nga Kantonet.

³ Kantonet mund të komunikojnë drejtëpërdrejtë me autritete të huaja të rangut më të ulët. Në rastet tjera, marrëdhëniet ndërmjet Kantoneve dhe shteteve tjera do të mbahen me ndërmjetësimin e Konfederatës.

Seksioni 2 Siguria, mbrojtja kombëtare, mbrojtja civile

Neni 57 Siguria

¹ Konfederata dhe Kantonet do të kujdesen për sigurinë e vendit dhe mbrojtjen e popullsisë brenda kompetencave të tyre.

² Ato do të kordinojnë përpjekjet e tyre në fushën e sigurisë së brendëshme.

Neni 58 Ushtria

¹ Zvicera do të ketë një ushtri e cila në parim do të jetë një ushtri e milicisë.

² Ushtria do të kontribuoj në parandalimin e luftimeve dhe në paqeruajtje, ajo gjithashtu siguron mbrojtjen e vendit dhe popullsisë. Ajo i ofron mbështetje autoriteteve civile kur ato përballen me kërcënim serioz të sigurisë së brendshme apo situata tjera të jashtëzakonshme. Me ligj mund të parashihen detyra tjera.

³ Themelimi i ushtrisë mbetet kompetencë të Konfederatës¹⁵.

¹⁵ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

Neni 59 Shërbimi ushtarak dhe shërbimi alternativ

¹ Çdo burrë i kombësisë zvicerane është i detyruar që të kryej shërbimin ushtarak. Ligji do të parasheh një shërbim civil alternativ.

² Zviceranet e gjinisë femërore mund të kryejnë shërbimin ushtarak në baza vullnetare.

³ Çdo burrë që i përket kombësisë zvicerane dhe nuk përmbush shërbimin ushtarak apo atë të shërbimit alternativ, do të paguaj një taksë.

⁴ Konfederata do të vendosë për kompenzim të drejtë të të ardhurave të humbura.

⁵ Personat që pësojnë dëmtim të shëndetit gjatë shërbimit ushtarak ose gjatë shërbimit alternativ kanë të drejtë që për vete apo për personat e afërm, të përfitojnë ndihmën e duhur nga Konfederata. Në rast të humbjes së jetës, të afërmit, kanë të drejtë në ndihmë.

Neni 60 Organizimi, trajnimi dhe pajisjet e ushtrisë

¹ Legjislacioni ushtarak si dhe organizimi, trajnimi dhe pajisjet e ushtrisë janë kompetencë e Konfederatës.

² ...¹⁶

³ Konfederata kundrejt një kompenzimi të arsyeshëm për Kantonet mund të marr instalimet ushtarake kantonale.

Neni 61 Mbrojtja civile

¹ Legjislacioni për mbrojtjen civile është kompetencë e Konfederatës. Mbrojtja civile ka për detyrë mbrojtjen e popullatës dhe pronave në rast të konfliktit të armatosur.

² Konfederata me dispozita do të rregulloj ndërhyrjen e mbrojtjes civile në rast të katastrofës dhe situatave urgjente.

³ Ajo mund të vendos që shërbimi i mbrojtjes civile të jetë i obliguar për personat e gjinisë mashkullore. Personat e gjinisë femërore mund të shërbejnë në mbrojtje civile në baza vullnetare.

⁴ Konfederata do të vendos lidhur me kompenzimin e drejtë të humbjes së të ardhurave me rastin e kryerjes së shërbimit të mbrojtjes civile.

⁵ Personat që pësojnë dëmtime të shëndetit gjatë kryerjes së shërbimit të mbrojtjes civile kanë të drejtë, që për vete apo për të afërmit, të përfitojnë ndihmë të përshtatshme nga Konfederata. Nëse humbin jetën, të afërmit e tyre kanë të drejtë në ndihmë.

Seksioni 3 Arsimi, hulumtimi shkencor dhe kultura**Neni 61a¹⁷** Zona zvicerane e edukimit

¹ Brenda kompetencave të tyre, Konfederata dhe Kantonet kujdesen së bashku për kualitetin dhe qasjen në zonen zvicerane të edukimit.

¹⁶ Shfuqizuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, me efekt nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

¹⁷ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO **2006** 3033; FF **2005** 5159 5225 6793, **2006** 6391).

² Ato do t'i kordinojnë përpjekjet e tyre dhe të sigurojnë një bashkëpunim përmes organeve të përbashkëta administrative dhe duke marrë masa tjera.

³ Ato do të sigurojnë që arsimiti i përgjithshëm dhe ai profesional të njihen si të barabarta nga komuniteti.

Neni 62 Shkollat publike*

¹ Sistemi i shkollor është përgjegjësi e Kantoneve.

² Kantonet do të sigurojnë një arsimim adekuat dhe të qasshëm për të gjithë fëmijët. Ky shkollim është i obliguar dhe mbikëqyret nga autoritetet publike. Është falas në shkollat publike¹⁸.

³ Kantonet do të sigurojnë shkollim special adekuat për fëmijët dhe adoleshtët me lëvizje të kufizuara, me së voni deri në moshën 20 vjeçare¹⁹.

⁴ Në rast se përpjekjet për harmonizim të shkollimit nuk kanë mundur të arrihen përmes kordinimit në fushat e moshës së regjistrimit në shkollë, kohëzgjatja si dhe objektivat e të nxënies, dhe kalimi nga një vit në vitin tjetër apo njohja reciproke diplomave, Konfederata do të marr masat e nevojshme²⁰.

⁵ Konfederata vendos për fillimin e vitit shkollor²¹.

⁶ Kantonet do të marrin pjesë në hartimin e akteve ligjore federale që prekin kompetencat e tyre, dhe opinionet e tyre kanë një peshë të veçantë²².

Neni 63²³ Arsimi profesional

¹ Arsimi profesional është i rregulluar me akte ligjore nga ana e Konfederatës.

² Ajo do të inkurajojë diversitetin dhe konkurrueshmërinë e këtij shkollimi.

¹⁸ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

¹⁹ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

²⁰ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

²¹ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

²² Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

²³ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

Neni 63a²⁴ Shkollimi i lartë

¹ Konfederata do të menaxhoj shkollat politeknike federale. Ajo mund të themeloj, përvetësoj apo të menaxhoj shkolla tjera të larta dhe institucione tjera nga fusha e arsimit të lartë.

² Ajo do t'i mbështes institucionet tjera kantonale të arsimit të lartë dhe mund të ndihmoj financiarisht institucionet tjera të arsimit të lartë të cilat ajo i njeh.

³ Konfederata dhe Kantonet janë së bashku përgjegjëse për kordinimin dhe garantimin e kualitetit në sistemin e arsimit të lartë zviceran. Duke vepruar kështu, ato duhet të kenë parasysh autonominë e institucioneve të arsimit të lartë dhe organeve tjera përgjegjëse, dhe të sigurojnë barazinë e institucioneve me funksione të njëjta.

⁴ Gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, Konfederata dhe Kantonet lidhin marrëveshje dhe disa nga kompetencat e tyre mund t'i delegojnë tek institucionet e përbashkëta. Me ligj parashihen kompetencat të cilat mund t'i delegohen këtyre organeve dhe definoen parimet e zbatueshme të organizatës dhe procedurave të kordinimit.

Neni 64 Hulumtimi shkencor

¹ Konfederata do të inkurajoj hulumtimin shkencor dhe shpikjet²⁵.

² Ajo mund të kushtëzoj ndihmën e saj në veçanti me sigurimin e kualitetit dhe me vendosjen e masave kordinuese²⁶.

³ Ajo mund të menaxhoj, themeloj apo të përvetësoj qendra kërkimore.

Neni 64a²⁷ Edukimi i vazhdueshëm

¹ Konfederata do të përcaktoj parimet e zbatueshme lidhur me edukimin e vazhdueshëm.

² Ajo mund të inkurajoj edukimin e vazhdueshëm.

³ Me ligj përcaktohen fushat dhe kriteret.

Neni 65 Statistikat

¹ Konfederata mbanë të dhënat e nevojshme statistikore lidhur me statusin dhe trendet e popullsisë, ekonomisë, shoqërisë, arsimit, kërkimit shkencor, territorit dhe mjedisit në Zvicër²⁸.

² Ajo mund të marr vendim për harmonizim dhe mirëmbajtje të regjistrave zyrtar në mënyrë që t'a zvogëloj koston e mbajtjes së statistikave.

²⁴ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

²⁵ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

²⁶ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

²⁷ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

²⁸ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

Neni 66 Ndhimat financiare për shkollim

¹ Konfederata mund të ju ndaj Kantoneve mjete për dhënien e ndihmave financiare për shkollim të destinuar për studentët e universiteteve dhe institucioneve tjera të arsimit të lartë. Ajo mund të inkurajoj harmonizimin ndër-kantonal në fushën e ndihmës financiare për shkollim dhe të vendos për parimet zbatueshme dhe kriteret²⁹.

² Si masa shtesë dhe duke respektuar autonominë kantonale në lëmin e shkollimit, ajo mund, ndër tjera, të ndërmarr masa lidhur me promovimin e shkollimit.

Neni 67 Inkurajimi i fëmijëve dhe të rinjëve³⁰

¹ Gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, Konfederata dhe Kantonet do të kenë parasysh nevojat e zhvillimit dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjëve.

² Si masë shtesë nga ato të Kantoneve, Konfederata mund të favorizoj aktivitete jashtë-shkollore për fëmijë dhe të rinjë³¹.

Neni 67a³² Shkollimi muzikor

¹ Konfederata dhe Kantonet inkurajojnë shkollimin muzikor, në veçanti, të fëmijëve dhe të rinjëve.

² Brenda kompetencave të tyre, Konfederata dhe Kantonet angazhohen që të promovojnë një mësimdhënie muzikore kualitative në shkollat publike. Nëse Kantonet me përpjekjet e tyre nuk arrijnë një harmonizim të qëllimeve për mësimdhënie të muzikore në shkolla, Konfederata do të marrë vendimet e nevojshme.

³ Konfederata me pjesëmarrjen e Kantoneve, rregullon parimet e zbatueshme lidhur me qasjen e të rinjëve në praktikimin e muzikës dhe inkurajimin e talenteve muzikore.

Neni 68 Sporti

¹ Konfederata do të inkurajoj sportin, në veçanti shkollimin në fushën e sportit.

² Ajo menaxhon një shkollë nga fusha e sportit.

³ Ajo mund të rregulloj praktikimin e sporteve nga të rinjët dhe të deklaroj të ogligueshëm mësimin e sportit nëpër shkolla publike.

Neni 69 Kultura

¹ Kantonet janë kompetente për kulturën.

²⁹ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

³⁰ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

³¹ Pranuar me votim popullor të datës 21 maj 2006, hyn në fuqi nga data 21 maj 2006 (Dekreti Federal i datës 16 dhjetor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 27 korrik 2006; RO 2006 3033; FF 2005 5159 5225 6793, 2006 6391).

³² Pranuar me votim popullor të datës 23 shtator 2012, hyn në fuqi nga data 23 shtator 2012 (Dekreti Federal i datës 15 mars 2012, Dekreti i Këshillit Federal i datës 29 janar 20013; RO 2013 435; FF 2009 57, 2010 1, 2012 3205 6417, 2013 1053).

² Konfederata mund të promovoj aktivitete kulturore që paraqesin interes kombëtar dhe inkurajon shprehjet artistike dhe muzikore, në veçanti promovon shkollimin nga kjo fushë.

³ Gjatë përmbushjes së detyrave të saj, Konfederata merr parasysh diversitetin kulturor dhe gjuhësor të vendit.

Neni 70 Gjuhët zyrtare

¹ Gjuhët zyrtare të Konfederatës janë gjuha gjermane, gjuha frënge dhe ajo italiane. Gjuha romanshe është gjithashtu gjuhë zyrtare në komunikimet ndërmjet Konfederatës dhe personave që flasin këtë gjuhë.

² Kantonet do të përcaktojnë gjuhët e tyre zyrtare. Në mënyrë që të ruhet harmonia në mes të komuniteteve linguistike, ato do të respektojnë ndarjen tradicionale dhe territoriale linguistike dhe do të marrin parasysh minoritetet linguistike autoktone.

³ Konfederata dhe Kantonet inkurajojnë të kuptuarit dhe komunikimin ndërmjet komuniteteve linguistike.

⁴ Konfederata do të mbështes Kantonet shumëgjuhësore në zbatimin e detyrave të tyre të veçanta.

⁵ Konfederata do të mbështesë masat e marra nga Kantonet Grison dhe Tessin për ruajtjen dhe promovimin e gjuhës romanch dhe gjuhës italiane.

Neni 71 Kinematografia

¹ Konfederata mund të promovoj prodhimet kinematografike zvicerane e gjithashtu edhe kulturen kinematografike.

² Ajo mund të rregulloj me dispozita inkurajimin e krijimtarisë së shumëllojshme kinematografike dhe kualitative.

Neni 72 Kisha dhe shteti

¹ Rregullimi i marrëdhënieve në mes të kishës dhe shtetit është kompetencë e Kantoneve.

² Brenda kompetencave të tyre, Konfederata dhe Kantonet mund të marrin masa që kanë për qëllim ruajtjen e paqes në mes të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme fetare.

³ Ndërtimi i minareve është i ndaluar³³.

Seksioni 4 Mjedisi dhe planifikimi hapsinor

Neni 73 Zhvillimi i qëndrueshëm

Konfederata dhe Kantonet do të përpiqen që të arrijnë një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të balancuar në mes të natyrës, në veçanti, kapacitetit të saj të ripërtëritjes dhe përdorimit të saj nga qenja njerëzore.

³³ Pranuar me votim popullor të datës 29 nëntor 2009, hyn në fuqi nga data 29 nëntor 2009 (Dekreti Federal i datës 12 dhjetor 2009, Dekreti i Këshillit Federal i datës 5 maj 2010; RO 2010 2161; FF 2008 6259 6923, 2009 3903, 2010 3117).

Neni 74 Mbrojtja e mjedisit

¹ Konfederata me dispozita do të rregulloj mbrojtjen e popullsisë dhe mjedisin e saj natyrorë nga efektet e dëmshme dhe të pakëndëshme.

² Ajo do të kujdeset që të parandaloj këto efekte. Shpenzimet për parandalimin dhe eliminimin e dëmtimit i ngarkohen palës e cila i shkakton ato.

³ Kantonet zbatojnë dispozitat federale nëse me ligj nuk bien në kompetencen e Konfederatës.

Neni 75 Planifikimi hapsinor

¹ Konfederata do të përcaktoj parimet e zbatueshme lidhur me planifikimin hapsinor. Këto parime janë detyruese për Kantonet dhe shërbejnë për të siguruar përdorim racional të tokës dhe territorit.

² Konfederata do të inkurajoj dhe kordinoj përpjekjet e Kantoneve dhe do të bashkëpunoj me to.

³ Konfederata dhe Kantonet do të marrin parasysh rregullat e përgjithshme të planifikimit hapsinor gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Neni 75a³⁴ Matja e territorit

¹ Matja i territorit është kompetencë e Konfederatës.

² Konfederata rregullon me dispozita matjen zyrtare.

³ Ajo mund të nxjerr dispozita për harmonizimin e informacioneve zyrtare lidhur me territorin.

Neni 75b³⁵ Shtëpitë e dyta*

¹ Shtëpitë e dyta nuk mund të përbëjnë më shumë se 20% të sipërfaqes totale të banueshme brenda një Komune.

² Ligji obligon Komunitat që çdo vit të publikojnë planin për shtëpi të banuara dhe një raport të hollsishtëm mbi zbatimin e tij.

Neni 76 Ujërat

¹ Brenda kompetencave të veta, Konfederata do të siguroj përdorimin racional dhe mbrojtjen e burimeve të ujit dhe lufton aktivitetet që dëmtojnë ujërat.

² Ajo do të përcaktoj parimet e zbatueshme për ruajtjen dhe shfrytëzimin e duhur të burimeve të ujit, përdorimin e ujit për prodhimin e energjisë dhe ftohje, si dhe ndërhyrjet tjera në ciklin ujor.

³ Ajo do të nxjerr dispozita për mbrojtjen e ujërave, për menaxhimin e rrjedhave ujore, për sigurinë e digave dhe për ndërhyrjet që mund të ndikojnë në reshje.

⁴ Kantonet kanë burimet e tyre të ujit. Brenda kompetencave të dhëna me legjislacion federal, ato mund të vjelin taksa për përdoruesit e tyre. Konfederata ka të drejtën e përdorimit të tyre për ndërmarrjet e veta të transportit dhe për këtë paguan një taksë si dëmshpërblim.

⁵ Në konsultim me Kantonet prekura, ajo vendos për të drejtat e burimeve të ujërave ndërkombëtare dhe përcakton tarifatat për përdorimin e tyre. Ajo gjithashtu vendos për këto të drejta kur burimet e ujit që janë me interes për disa Kantone dhe ato nuk pajtohen.

³⁴ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002, 2003 6035, 2005 883).

³⁵ Pranuar me votim popullor të datës 11 mars 2012, hyn në fuqi nga data 11 mars 2012 (Dekreti Federal i datës 17 qershor 2011, Dekreti i Këshillit Federal i datës 20 qershor 2012; RO 2012 3627; FF 2008 1003 7891, 2011 4473, 2012 6149).

⁶ Gjatë përmbushjes së detyrave të saj, ajo do të marr parasysh interesat e Kantoneve nga të cilat buron uji.

Neni 77 Pyjet

¹ Konfederata do të kujdeset që pyjet të mund përmbushin funksionet e tyre mbrojtëse, ekonomike e sociale.

² Ajo përcakton parimet e zbatueshme për mbrojtjen e pyjeve.

³ Ajo do të inkurajoj masat që merren për me qëllim të ruajtjes së pyjeve.

Neni 78 Mbrojtja e natyrës dhe trashëgimisë kulturore

¹ Kantonet janë kompetente për mbrojtjen e natyrës dhe trashëgimisë kulturore.

² Gjatë përmbushjes së detyrave të saj, Konfederata merr parasysh objektivat e saj për mbrojtjen e natyrës dhe trashëgimisë kulturore. Mbronë pisazhet, fizionominë e lokaliteteve, vendet historike dhe monumentet natyrore e kulturore, dhe i mbanë në tërësinë e tyre nëse një gjë të tillë e kërkon interesi publik.

³ Ajo mund të mbështesë përpjekjet për të mbrojtur natyrën dhe trashëgiminë kulturore, të marrë apo të mbajë në pronësi përmes kontraktimit ose shpronësimit të detyrueshëm, objektet që paraqesin interes kombëtar.

⁴ Ajo do të nxjerr dispozita për mbrojtjen e florës dhe faunës dhe për ruajtjen e mjedisit natyror në diversitetin e saj. Ajo do të mbrojë llojet e kërcënuara me zhdukje.

⁵ Kënetat dhe moçalet e një bukurie të veçantë të cilat paraqesin një rëndësi kombëtare janë të mbrojtura. Është i ndaluar ndërtimi apo modifikimi i vendit. Përfundimisht bëjnë objektet të cilat shërbejnë për mbrojtjen e këtyre zonave ose për shfrytëzimin e tyre për qëllime bujqësore.

Neni 79 Peshkimi dhe gjahu

Konfederata do të përcaktoj parimet e zbatueshme për praktikimin e peshkimit dhe gjahut, e veçanërisht ruajtjen diversitetet të llojeve të peshkut, gjitarëve dhe zogjve.

Neni 80 Mbrojtja e kafshëve

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita lidhur me mbrojtjen e kafshëve.

² Ajo rregullon në veçanti:

- a. mbajtjen e kafshëve dhe trajtimin e tyre;
- b. eksperimentimin me kafshë dhe shkeljen e integritetit të kafshëve të gjalla;
- c. përdorimin e kafshëve;
- d. importimin e kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore;
- e. tregtimi me kafshë dhe transporti i tyre;
- f. therjen e kafshëve.

³ Zbatimi i dispozitave federale është përgjegjësi e Kantoneve me përjashtim kur me ligj është rezervuar për Konfederatën.

Seksioni 5 Punët publike dhe transporti

Neni 81 Punët publike

Konfederata, në interes të vendit ose të një pjese të madhe të tij, mund të kryej punë dhe vepra publike ose të inkurajojë realizimin e tyre

Neni 81a³⁶ Transporti publik

¹ Konfederata dhe Kantonet do të sigurojnë që të ofrohen forma të mjaftueshme të transportit publik përmes hekurudhave, rrugëve, lundrimit dhe instalimeve kabllore në të gjitha regjionet e vendit.

² Kosotoja e trafikut publik duhet të mbulohet në një masë të mjaftueshme nga çmimet e paguara nga përdoruesit e tij.

Neni 82 Transporti rrugor

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita lidhur me transportin rrugor.

² Ajo do të mbikqyrë rrugët e rëndësisë kombëtare dhe mund të përcaktojë rrugët e tranzitit që duhet të jenë të hapura për trafik.

³ Rrugët publike mund të shfrytëzohen pa pagesë. Asambleja federale mund të autorizoj përjashtime.

Neni 83 Infrastruktura rrugore³⁷

¹ Konfederata dhe Kantonet sigurojnë që të ketë infrastrukturë të mjaftueshme rrugore në të gjitha regjionet e vendit.

² Konfederata do të siguroj krijimin e një rrjeti kombëtarë të rrugëve dhe do të siguroj që ai të jetë i përdorshëm. Ajo do të ndërtoj, mirëmbajë dhe do të operoj me rrugët kombëtare. Ajo do të bart koston. Ajo mund t'ia besojë këto detyra pjesërisht ose plotësisht organizatave publike, private apo mikse.

Neni 84 Tranziti alpin*

¹ Konfederata do të mbroj rajonet e alpeve kundër efekteve negative të trafikut tranzit. Ajo do të kufizoj shqetësimet e shkaktuara nga trafiku tranzit në mënyrë që ato mos të shkaktojnë dëme tek njerëzit, kafshët, bimët, dhe as në hapsirat e tyre jetësore.

² Transporti i mallërave nëpër Zvicër në akset alpine do të bëhet përmes hekurudhës. Këshilli Federal do të marr masat e nevojshme. Përjashtim nga ky rregull mund të ketë vetëm në rastet e pashmangshme. Ato duhet të specifikohen me ligj.

³ Kapaciteti i rrugëve tranzite alpine nuk mund të rritet. Nuk i nënshtrohen kësaj dispozite rrugët anashkaluese që reduktojnë nivelin e trafikut tranzit në qytete dhe fshatra.

³⁶ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2014, hyn në fuqi nga data 1 janar 2016 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 maj 2014; DKF i dates 6 qershor 2014; RO 2015 645; FF 2010 6049 5225, 2012 1371, 2013 4191 5872, 2014 3953 3957).

³⁷ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2018 (Dekreti Federal i datës 18 shkurt 2015, Dekreti i Këshillit Federal i datës 30 shtator 2016; DKF i datës 13 prill 2017; RO 2017 6731; FF 2015 1899, 2016 7371 8121, 2017 3213).

Neni 85 Tarifa mbi qarkullimin e automjeteve të rënda

¹ Konfederata mund të vendosë një tarifë mbi qarkullimin e automjeteve për mallrave të peshave të rënda kur ky qarkullim shkakton kosto publike të cilat nuk janë të mbuluara nga të hyra tjera.

² Të hyrat neto nga kjo tarifë shërbejnë për të mbuluar koston e transportit tokësor³⁸.

³ Kantonet përfitojnë nga një pjesë nga këto të hyra. Gjatë llogaritjes së këtyre të hyrave, duhet të merren parasysh pasojat e veçanta të shpërndarjes së taksës për rajonet malore dhe rajonet periferike.

Neni 85^{a39} Taksa për përdorimin e rrugëve kombëtare

Konfederata mund të vjel një taksë për përdorimin e rrugëve kombëtare nga automjetet dhe ngarkesat që nuk i nënshtrohen taksës mbi lëvizjen e automjeteve dhe mallrave.

Neni 86⁴⁰ Përdorimi i të hyrave për nevoja dhe shpenzime të lidhura me qarkullimin rrugor*

¹ Financimi i rrugëve kombëtare dhe kontributet për përmirësimin e infrastrukturës së transportit në qytete dhe zonat urbane në lidhje me trafikun rrugor, do të sigurohen nga një fond i cili do të krijohet.

² Fondi mundësohet nga mjetet e mëposhtme:

- a. të hyrat neto nga taksa për shfrytëzimin e rrugëve kombëtare të parashikuara me Nenin 85a;
- b. të hyrat neto nga tatimi i veçantë i konsumit të parashikuara me Nenin 131, par.1, shkronja d;
- c. të hyrat neto nga taksa e parashikuar me Nenin 131, par. 2, shkronja a;
- d. të hyrat e neto nga taksa e parashikuar me Nenin 131, par. 2, shkronja b;
- e. një pjesë e të ardhurave neto të tatimit për konsum mbi lëndët djegëse me përjashtim të karburanteve të aviacionit në pajtim me Nenin 131, par. 1, shkronja e; kjo pjesë korrespondon me 9% të mjeteve të parashikuara me shkronjën c, dhe 9% e gjysmës së të ardhurave të tatimit mbi konsumin e mbledhur nga të gjitha lëndët djegëse me përjashtim të karburanteve të aviacionit, por jo më shumë se 310 milionë franga në vit; indeksimi i tij rregullohet me ligj;
- f. si rregull i përgjithshëm, 10 % e të ardhurave neto nga tatimi në konsum për të gjitha lëndët djegëse, me përjashtim të karburanteve të aviacionit, në përputhje me Nenin 131, par. 1, shkronja e;
- g. ...⁴¹
- h. mjetet tjera financiare në lidhje me qarkullimin rrugor të parapara me ligj.

³⁸ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2014, hyn në fuqi nga data 1 janar 2016 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 maj 2014; DKF i dates 6 qershor 2014; RO 2015 645; FF 2010 6049 5225, 2012 1371, 2013 4191 5872, 2014 3953 3957).

³⁹ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2018 (Dekreti Federal i datës 18 shkurt 2015, Dekreti i Këshillit Federal i datës 30 shtator 2016; DKF i datës 13 prill 2017; RO 2017 6731; FF 2015 1899, 2016 7371 8121, 2017 3213).

⁴⁰ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2018 (Dekreti Federal i datës 18 shkurt 2015, Dekreti i Këshillit Federal i datës 30 shtator 2016; DKF i datës 13 prill 2017; RO 2017 6731; FF 2015 1899, 2016 7371 8121, 2017 3213).

⁴¹ Akoma nuk është fuqizuar.

³ Një financim i posaçëm si në vijim menaxhohet për detyrat dhe shpenzimet lidhur me trafikun rrugor:

- a. kontributet lidhur me masat për promovimin e transportit të kombinuar dhe transportin e veturave dhe shoferëve;
- b. kontributet lidhur me shpenzimet e rrugëve kryesore;
- c. kontributet për strukturat e mbrojtëse kundër fatëkeqësive natyrore dhe për masat e mbrojtjes së mjedisit dhe peisazhit nga efektet e trafikut rrugor;
- d. kontributet e përgjithshme nga kostoja e shkaktuara nga Kantonet për hapjen e rrugëve për automjete;
- e. kontributet për Kantonet që nuk posedojnë rrugë kombëtare;
- f. hulumtimi dhe administrimi.
- g. ...⁴²

⁴ Gjysma e të ardhurave neto nga tatimi për konsum të mbledhur për të gjitha lëndët djegëse, përveç karburanteve të aviacionit, në përputhje me Nenin 131, par. 1, shkronja e, është kredituar në fonde të posaçme pas zbritjes së mjeteve të parapara në paragrafin 2, shkronja e.

⁵ Nëse financimi i posaçëm është provuar si i nevojshëm, në mënyrë që të themelohen rezerva të duhura në programin e financimit të posaçëm, të ardhurat nga tatimi në konsum të parapara në Nenin 131, par. 1, shkronja d, do të ngarkohen në programin e fondit të posaçëm në vend të fondit.

Neni 87 Hekurudhat dhe format tjera të transportit^{43*}

Legjislacioni lidhur me transportin hekurudhor, teleferikët, lundrimin, aviacionin dhe navigimin hapsiror mbetet kompetencë e Konfederatës.

Neni 87a⁴⁴ Infrastruktura hekurudhore

¹ Konfederata do të bartë barrën kryesore të financimit të infrastrukturës hekurudhore.

² Financimi i infrastrukturës hekurudhore do të sigurohet nga një fond. Ky fond do të mundësohet nga:

- a. jo më shumë se dy të tretat e të hyrave nga tarifimi i automjeteve me pesha të rënda të parapara me Nenin 85;
- b. të hyrat që rezultojnë nga rritja e normave të tatimit mbi vlerën e shtuar të parapara me Nenin 130, par. 3;
- c. 2.0 % e të hyrave nga tatimi federal në të ardhura të mbledhura nga personat fizikë;
- d. 2300 milion franga në vit nga financat federale. Indeksimi i kësaj shume do të rregullohet me ligj.

³ Kantonet marrin pjesë në financimin e infrastrukturës hekurudhore në mënyrë të përshtatshme. Me ligj do të rregullohen hollësitë.

⁴² Akoma nuk është fuqizuar.

⁴³ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2018 (Dekreti Federal i datës 18 shkurt 2015, Dekreti i Këshillit Federal i datës 30 shtator 2016; DKF i datës 13 prill 2017; RO 2017 6731; FF 2015 1899, 2016 7371 8121, 2017 3213).

⁴⁴ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2014, hyn në fuqi nga data 1 janar 2016 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 maj 2014; DKF i dates 6 qershor 2014; RO 2015 645; FF 2010 6049 5225, 2012 1371, 2013 4191 5872, 2014 3953 3957).

⁴ Me ligj mund të prashihen mënyra shtesë të financimit nga burime tjera.

Neni 87b⁴⁵ Përdorimi i të hyrave për përmbushjen e përgjegjësisive lidhur me trafikun ajror Gjysma e të hyrave neto nga tatimi në konsum për karburantet e aviacionit dhe shtesës së karburantit të aviacionit do të përdoren për realizimin e detyrave dhe shpenzimeve lidhur me trafikun ajror:

- a. kontributet për masat e mbrojtjes së mjedisit për shkak të trafikut ajror;
- b. kontributet për masat e sigurisë për të mbrojtur trafikun ajror, duke përfshirë sulmet terroriste dhe rrëmbimet, me kusht që masat e tilla të mos jenë përgjegjësi e autoriteteve publike;
- c. kontributet për masat që kanë për qëllim promovimin e nivelit të lartë sigurisë teknike në trafikun ajror.

Neni 88 Rrugët dhe shtigjet për këmbësorë

¹ Konfederata do të përcaktoj parimet e zbatueshme lidhur me rrugët dhe shtigjet për këmbësorë.

² Ajo mund të mbështes dhe kordinoj masat kantonale për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e këtyre rrjeteve.

³ Në përmbushjen e detyrave të saj, ajo merr parasysh rrjetin e rrugëve dhe shtigjeve për këmbësorët dhe zëvendëson rrugët dhe shtigjet të cilat duhet të mbyllen.

Seksioni 6 Energjia dhe komunikimi

Neni 89 Politikat energjetike

¹ Brenda kompetencave të tyre, Konfederata dhe Kantonet angazhohen në promovimin e një furnizimi energjetik të mjaftueshëm, të larmishëm, të sigurtë, ekonomikisht të favorshëm dhe miqësor ndaj mjedisit, si dhe një konsumim ekonomik dhe racional të energjisë.

² Konfederata do të përcaktoj parimet e zbatueshme për përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe konsumit ekonomik dhe racional të saj.

³ Konfederata do të rregulloj me dispozita konsumimin e energjisë me instalime, makina dhe pajisje. Ajo promovon zhvillimin e teknologjive energjetike, dhe në veçanti në fushat e kursimit të energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme.

⁴ Masat që lidhen me konsumin e energjisë në ndërtesa do të jenë kryesisht përgjegjësi e Kantoneve.

⁵ Në politikat e saj për energjinë, Konfederata do të marr parasysh përpjekjet e Kantoneve, Komunave dhe komuniteteve ekonomike, si dhe realitetin e secilit regjion dhe kufijtë e asaj se çfarë është e përballueshme.

⁴⁵ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2018 (Dekreti Federal i datës 18 shkurt 2015, Dekreti i Këshillit Federal i datës 30 shtator 2016; DKF i datës 13 prill 2017; RO 2017 6731; FF 2015 1899, 2016 7371 8121, 2017 3213).

Neni 90 Energjia bërthamore*

Legjislacioni lidhur me energjinë bërthamore bie në kompetencë të Konfederatës.

Neni 91 Transportimi i energjisë

¹ Konfederata me dispozita do të rregulloj transportimin dhe furnizimin me energji elektrike.

² Konfederata është përgjegjëse për nxjerrjen e legjislacionit lidhur me instalimet e transportimit të karburanteve të lëngëta ose të gazta.

Neni 92 Shërbimi postal dhe i telekomunikacionit

¹ Konfederata është kompetente për shërbimet e postës dhe telekomunikimit.

² Konfederata siguron që një shërbim universal dhe i mjaftueshëm i shërbimeve të postës dhe të telekomunikimit do të jetë i qasshëm për çmim të arsyeshëm në të gjitha regjionet e vendit.

Neni 93 Radio dhe televizioni

¹ Konfederata është kompetente për nxjerrjen e legjislacionit për radio dhe televizion, si dhe për forma tjera të shpërndarjes së informacionit.

² Radio dhe televizioni kontribuojnë në edukim dhe zhvillim kulturor, në formimin e lirë të mendimit dhe në argëtim. Ato duhet të marrin parasysh veçantitë e vendit dhe nevojat e Kantoneve. Ato do të paraqesin ngjarjet me besnikëri dhe pasqyrojnë shumëllojshmërinë e mendimeve në mënyrë të barabartë.

³ Pavarësia e radios dhe televizionit si dhe autonomia në hartimin e programeve janë të garantuara.

⁴ Roli dhe detyrat e mediave tjera dhe në veçanti shtypit duhet të merret parasysh.

⁵ Ankesat lidhur me programet mund t'i dorëzohen një autoriteti të pavarur.

Seksioni 7 **Ekonomia****Neni 94** Parimet e sistemit ekonomik

¹ Konfederata dhe Kantonet do të respektojnë parimin e lirisë ekonomike.

² Ato angazhohen për të mbrojtur interesat e ekonomisë kombëtare dhe së bashku me sektorin privat do të kontribuojnë në prosperitetin dhe sigurinë ekonomike të popullatës.

³ Brenda kompetencave të tyre, ato do të kujdesen që të krijojnë një mjedis të favorshëm në sektorin e ekonomisë private.

⁴ Shmangia nga parimi i lirisë ekonomike, sidomos masat që kërcënojnë konkurrencën, lejohen vetëm në rastet kur parashihen me Kushtetutën federale apo në bazë të legjislacionit kantonal.

Neni 95 Aktivitetet ekonomike fitimprurëse në sektorin privat*

¹ Konfederata mund të nxjerr dispozita për ushtrimin e aktiviteteve ekonomike fitimprurëse në sektorin privat.

² Ajo do të synoj krijimin e një zone unike ekonomike. Ajo do t'i garantoj personave që kanë një shkollim universitar ose një formim federal, kantonal ose një shkollim të njohur nga një Kanton se do të mund të ushtrorjnë profesionin e tyre në të gjithë Zvicrën.

³ Me qëllim të mbrojtjes së ekonomisë, pronës private dhe aksionarëve dhe për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të bizneseve, me ligj do të rregullohet që shoqëritë anonime të listohen në bursën e Zvicrës ose në vendet tjera duke respektuar parimet e mëposhtme:

- a. asambleja e përgjithshme voton çdo vit për shumën totale të shpërblimit (para dhe vlera të përfitimeve në natyrë) të bordit të drejtorëve, menaxhimit dhe komitetit këshillues. Ajo zgjedh çdo vit kryesuesin e bordit të drejtorëve dhe një nga një, anëtarët e bordit të drejtorëve dhe anëtarët e komisionit të kompenzimit si dhe përgaqsuesin e pavarur. Fondet pensionale votojnë në interes të siguruarve të tyre dhe atë publikojnë atë që kanë votuar. Aksionarët mund të votojnë nga distanca në formë elektronike. Ata nuk mund të përfaqësohen nga një anëtar i një organi të një shoqërie ose nga një bankë;
- b. anëtarët e organeve nuk marrin shpërblim apo kompenzim tjetër, shpërblim paraprak për blerjet apo shitjet e shoqërive dhe nuk mund të lidhin kontrata konsulence apo pune me një kompani të grupit. Menaxhimi i shoqërisë nuk mund të delegohet tek personat tjetër ligjor.
- c. statutet rregullojnë shumën kredive, huave të dhëna anëtarëve, bonuseve, planeve të pjesëmarrjes dhe numrin e mandateve të këtyre të fundit si dhe kohëzgjatjen e kontratave të punës të anëtarëve të menaxhmentit;
- d. Çdo shkelje e dispozitave të parapara me shkronjat a deri c do të dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me gjobë deri në gjashtë paga vjetore⁴⁶.

Neni 96 Politikat lidhur me konkurrencën

¹ Konfederata do të nxjerrë dispozita për të luftuar pasojat e dëmshme sociale dhe ekonomike të karteleve dhe formave tjera me të cilat kufizohet konkurrenca.

² Ajo do të ndërmarr marr masa:

- a. që të parandaloj abuzimin me çmime nga ndërmarrje ose organizata private apo publike që kanë pozitë dominuese në treg;
- b. që të luftoj konkurrencën jo-lojale.

Neni 97 Mbrojtja e konsumatorit

¹ Konfederata do të marr masa që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

² Ajo do të nxjerr dispozita lidhur me mjetet juridike në dispozicionin të organizatave të konsumatorëve. Në fushën e konkurrencës jo-lojale, këto organizata gëzojnë të njëjtat të drejta sikurse organizatat profesionale dhe ekonomike;

³ Kantonet do të parashohin një procedurë pajtimi apo një procedurë të shpejtë dhe të lehtë ligjore lidhur me mosmarrëveshjet, vlera e të cilave nuk guxon të tejkalojë shumën fikse. Këshilli federal do të përcaktoj këtë shumë.

Neni 98 Bankat dhe kompanitë e sigurimeve

¹ Konfederata do të nxjerrë dispozita lidhur me bankat dhe bursat duke marr parasyshë rolin dhe statusin e veçantë të bankave kantonale.

⁴⁶ Pranuar me votim popullor të datës 3 mars 2013, hyn në fuqi nga data 3 mars 2013 (Dekretet e Këshillit Federal të datave 15 nëntor 2012 dhe 30 prill 2013; RO 2013 1303; FF 2006 8319, 2008 2325, 2009 265, 2012 8503, 2013 2759).

² Ajo mund të nxjerr dispozita për shërbimet tjera financiare në fusha tjera.

³ Ajo do të nxjerr dispozita për sigurimet private.

Neni 99 Politikat monetare

¹ Konfederata është kompetente për monedhën; e drejta për të prodhuar monedhën është e drejtë ekskluzive e Konfederatës.

² Banka Kombëtare si bankë qendrore dhe pavaruar ka një politikë monetare që është në shërbim të interesave të përgjithshme të vendit. Ajo administrohet me ndihmën dhe nën mbikëqyrjen e Konfederatës.

³ Banka Kombëtare prodhon rezerva të mjaftueshme monetare një pjesë e të cilave duhet të përbëhet nga floriri.

⁴ Ajo do t'u ndajë jo më pak se dy të tretat e fitimit neto Kantoneve.

Neni 100 Politikat ekonomike

¹ Konfederata do të ndërmarr hapa për të siguruar një zhvillim ekonomik të balancuar, në veçanti, për të parandaluar papunësinë dhe inflacionin.

² Ajo do të marr parasysht specifikat e zhvillimit ekonomik për çdo rajon. Ajo do të bashkëpunoj me Kantonet dhe komunitetin e biznesit.

³ Në fushat e kredisë dhe monedhës, tregtisë së jashtme dhe financave publike, ajo mund, kur është e nevojshme të shmangë zbatimin e parimit të lirisë ekonomike.

⁴ Konfederata, Kantonet dhe Komunitatet përcaktojnë politikat e tyre buxhetore duke marr parasysht situatën ekonomike.

⁵ Me qëllim të stabilizimit të ekonomisë, Konfederata përkohësisht mund të vendos mbitaksa ose të zbresë grantet dhe taksat federale. Fondet e grumbulluara duhet të jenë të ngrira. Kur kjo masë hiqet, taksat dhe detyrimet e drejtëpërdrejta rimbursohen individualisht, dhe tatimet dhe taksat indirekte zbatohen për zbritjet ose krijimin e vendeve të punës.

⁶ Konfederata mund të obligoj kompanitë që të krijojnë rezerva për raste të krizave; për këtë qëllim, ajo bënë koncesione tatimore dhe mund të obligoj edhe Kantonet për të bërë koncesione të njëjta. Kur rezervat lirohen, kompanitë vendosin lirisht për përdorimin e tyre brenda kufijve të parashikuar me ligj.

Neni 101 Politikat e ekonomisë së jashtme

¹ Konfederata do të mbrojë interesat e ekonomisë zvicerane në vendet tjera.

² Në raste të veçanta, ajo mund të ndërmarr masa për të mbrojtur ekonominë zvicerane. Nëse është e nevojshme, ajo mund të heqë dorë nga parimi i lirisë.

Neni 102 Furnizimi i vendit*

¹ Konfederata siguron furnizimin e vendit me mallra dhe shërbime thelbësore për t'u përballur me kushte lufte, me ndonjë manifestim tjetër të forcës ose një mungesë serioze për të cilën ekonomia nuk është në gjendje t'a përmirësoj me mjetet e veta. Ajo merr masa parandaluese.

² Ajo, sipas nevojës, mund të shmangë zbatimin e parimit të lirisë ekonomike.

Neni 103 Politikat strukturore*

Konfederata mund të mbështesë zonat rrezikuara ekonomikisht dhe të promovojë degë të ekonomisë dhe profesione nëse ato me masat e vetanake të arsyeshme dhe që priten nga ta nuk janë të mjaftueshme për të siguruar ekzistencën e tyre. Ajo, sipas nevojës, mund të shmangë zbatimin e parimit të ekonomisë së lirë.

Neni 104 Bujqësia

¹ Konfederata do të siguroj që bujqësia, duke ju përgjigjur me prodhim kërkesës së zhvillimit të qëndrueshëm dhe kërkesës së tregut, kontribuon ndjeshëm:

- a. në sigurinë e furnizimit të popullsisë;
- b. në ruajtjen e burimeve natyrore dhe ruajtjen e peisazhit rural;
- c. në decentralizimin e menaxhimit të territorit.

² Përveç masave të vetë-ndihmës që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga sektori i bujqësisë dhe duke përjashtuar, nëse është e nevojshme, parimin e zbatimit të lirisë ekonomike, Konfederata do të ndihmoj fermat që kultivojnë tokën.

³ Ajo harton masat në atë mënyrë që sektori i bujqësisë t'i përgjigjet funksioneve të shumta të saj:

- a. ajo plotëson të ardhurat e fermerëve përmes pagesave direkte me qëllim të shpërblimit barabartë për shërbimet e ofruara, me kusht që fermerët të demonstrojnë se i plotësojnë kërkesat ekologjike;
- b. ajo inkurajon, me anë të stimujve me interes ekonomik, format e shfrytëzimit veçanërisht në harmoni me natyrën dhe respektimin e mjedisit dhe kafshëve;
- c. ajo nxjerr dispozita lidhur me deklarin e origjinës, kualitetit, metodave të prodhimit dhe proceseve të përpunimit të ushqimit;
- d. ajo mbronë mjedisin nga abuzimi me plehra kimike, produkte kimike dhe materiale tjera ndihmëse;
- e. ajo mund të inkurajoj zbulimet agrokulturore, zgjerimin dhe trajnimin si dhe të sigurojë ndihmë në investime;
- f. Ajo mund të nxjerr dispozita për konsolidimin e pronësisë së tokës bujqësore.

⁴ Për këto qëllime, Konfederata do të ndajë kredi bujqësore me qëllim të posaçëm si dhe burime të përgjithshme federale.

Neni 104a⁴⁷ Siguria në ushqim

Për të siguruar furnizimin e popullsisë me ushqim, Konfederata krijon kushte për:

- a. ruajtjen e bazave të prodhimit bujqësor, veçanërisht të tokës bujqësore;
- b. prodhimin e ushqimit të përshtatur ndaj kushteve lokale dhe përdorimin e burimeve efikase;
- c. një sektor bujqësor dhe një sektor agro-ushqimor që plotëson kërkesat e tregut;
- d. lidhjen e marrëshënive tregtare ndërkuftare që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe sektorit agro-ushqimor;

⁴⁷ Pranuar me votim popullor të dates 24 shtator 2017, hyn në fuqi nga data 24 shtator 2017 (Dekreti Federal i datës 14 mars 2017, Dekreti i Këshillit Federal i datës 30 nëntor 2017; RO 2017 6735; FF 2014 5919, 2015 5273, 2017 2321 7399).

- e. përdorimin e ushqimit në atë mënyrë që të ruajë burimin natyral.

Neni 105 Alkooli

Legjislacioni lidhur me fabrikimin, importimin, koriggjimin dhe shitjen e alkoolit të destiluar është përgjegjësi e Konfederatës. Ajo merr parasysht në veçanti efektet e dëmshme të alkoolit.

Neni 106⁴⁸ Lojrat e fatit

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita lidhur me lojrat e fatit duke marrë parasysht interesat e Kantoneve.

² Një liçencë nga Konfederata është e nevojshme për të hapur një biznes të lojrave të fatit. Kur ajo lëshon një liçencë, merr parasysht realitetin rajonal. Ajo do të vjel një taksë nga bizneset e lojrave të fatit e cila nuk duhet të kalojë 80% të produktit bruto nga të ardhurat e tyre.

³ Autorizimi dhe mbikëqyrja e lojrave të fatit në vijim janë përgjegjësi e Kantoneve:

- a. lojrat në të cilat mund të luaj një numër i pakufizuar i personave dhe mund të marrin pjesë në më shumë se një vend dhe ruzultati i të cilave përcaktohet nga barazimi i përbashkët ose nga një proces i ngjashëm, me përjashtim të sistemeve të xhek potit në lokalet e lojrave të fatit;
- b. bastet sportive;
- c. lojrat e aftësive.

⁴ Paragrafët 1 dhe 2 do të zbatohen edhe për lojrat e fatit që luhen në formë elektronike.

⁵ Konfederata dhe Kantonet do të marrin parasysht rreziqet e lojrave të fatit. Ato do të marrin masat e nevojshme legjislative dhe mbikëqyrëse për të siguruar mbrojtje të përshtatshme nga specifikat e lojrave të fatit si dhe mënyrën e shfrytëzimit të ofertës.

⁶ Kantonet do të sigurojnë që përfitimet neto nga lojrat e fatit të përmendura në paragrafin 3, shkronjat a dhe b, do të shfrytëzohen për qëllime publike dhe veçanërisht për aktivitetet kulturore, sociale dhe sportive.

⁷ Konfederata dhe Kantonet bashkërendojnë përpjekjet e tyre në përmbushjen e detyrave të tyre. Ligji përcakton për këtë qëllim një organ të përbashkët të përbërë në mënyrë të barabartë nga anëtarët e autoriteteve ekzekutive të Konfederatës dhe anëtarë të autoriteteve kantonale.

Neni 107 Armët dhe materialet e luftës

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita kundër këqpërdorimit të armëve, pajisjeve të armëve dhe minicioneve.

² Ajo do të nxjerr dispozita lidhur me fabrikimin, blerjen, shpërndarjen, importimin, eksportimin dhe tranzitin e materialit të luftës.

⁴⁸ Panuar me votim popullor të datës 11 mars 2012, hyn në fuqi nga data 11 mars 2012 (Dekreti Federal i datës 17 qershor 2011, Dekreti i Këshillit Federal i datës 20 qershor 2012; RO 2012 3627; FF 2008 1003 7891, 2011 4473, 2012 6149).

Seksioni 8 Banimi, puna, Sigurimi social dhe Shëndetësia

Neni 108 Ndërtimi i vendbanimeve dhe pronësia

¹ Konfederata do të inkurajoj ndërtimin e banesave, si dhe blerjen e apartamenteve dhe shtëpive familjare për përdorim personal nga individët dhe aktivitetet ndërtuesve dhe organizatave të përfshira në ndërtimin e ndërtesave publike.

² Në veçanti, ajo do të inkurajoj blerjen dhe zhvillimin e tokës për ndërtim të banesave, racionalizimin e ndërtimit, uljen e kostos së saj dhe uljen e kostos së banimit.

³ Ajo mund të nxjerr dispozita mbi pajisjen e terreneve ndërtimore dhe për racionalizimin e ndërtimit.

⁴ Duke vepruar kështu, ajo merr parasysh interesat e familjeve dhe të moshuarve, të paaftëve dhe personave në nevojë.

Neni 109 Kontrata e qiradhënies

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita kundër keqpërdorimit me kontrata të qirasë, duke përfshirë qiratë abuzive, procedurat për ankimim kundër përfundimit të jashtëligjshëm të kontratës mbi qiranë dhe zgjatjen e qirasë për një afat të caktuar.

² Ajo mund të nxjerr dispozita me fuqi të përgjithshme detyruese për kontratat-kornizë të qiradhënies. Për t'u shpallur me fuqi të përgjithshme detyruese, këto kontrata duhet të marrin parasysh interesat legjitime të minoriteteve dhe veçoritë rajonale dhe të respektojnë parimin e barazisë para ligjit.

Neni 110 Marrëdhënia e punës

¹ Konfederata mund të nxjerr dispozita:

- a. për mbrojtjen e punëtorëve;
- b. për raportet midis punëdhënësve dhe punëtorëve duke përfshirë rregullimin e përbashkët të çështjeve që prekin ndërmarrjen dhe fushën profesionale;
- c. për shërbimin e rekrutimit;
- d. për shtrirjen fushëveprimit të kontratave kolektive.

² Fushëveprimi i një kontrate kolektive mund të zgjerohet vetëm nëse merr parasysh në mënyrë të barabartë interesat legjitime të pakicave dhe veçoritë rajonale dhe respekton parimin e barazisë para ligjit dhe lirinë sindikale.

³ 1 Gushti është dita kombëtare. Nga pikëpamja e ligjit të punës konsiderohet si ditë e diel dhe paguhet.

Neni 111 Skemat kursimeve të pleqërisë, bashkëshortëve mbijetues dhe ato invalide

¹ Konfederata do të ndërmarr hapa për të siguruar pensione të mjaftueshme pleqërie, për bashkëshortët mbijetues dhe për personat me aftësi të kufizuara. Ky plan pensionesh bazohet në tre shtyllat e sigurimit pensional, të sigurimit të bashkëshortëve mbijetues dhe të sigurimit të personave me aftësi të kufizuara si dhe të sigurimit profesional dhe individual.

² Konfederata do të siguroj që skemat federale të sigurimit të pleqërisë, të bashkëshortëve mbijetues dhe personave me aftësi të kufizuara si dhe të siguruarve profesional të mund të kryejnë funksionin e tyre në mënyrë të qëndrueshme.

³ Ajo mund të kërkoj nga Kantonet që të bëjnë përjashtime nga taksat për institucionet që mbulohen nga sigurimi i pleqërisë, bashkëshortëve mbijetues dhe personave me aftësi të kufizuara ose të sigurimit profesional dhe t'i liroj nga përgjegjësia për të paguar taksat.

⁴ Në bashkëpunim me Kantonet, ajo promovon skemat pensionale individuale, veçanërisht përmes masave tatimore dhe një politike që lehtëson pronësinë.

Neni 112 Sigurimi i pleqërisë, bashkëshortëve mbijetues dhe sigurimi invalidor

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita për sigurimin e pleqërisë, bashkëshortëve mbijetues dhe sigurimin invalidor.

² Duke vepruar kështu, ajo respekton parimet në vazhdim:

- a. sigurimi është i obligueshëm
- a^{bis}.⁴⁹ ajo siguron përfitime në para dhe natyrë;
- b. pensionet duhet të mbulojnë nevojat jetike në mënyrë të përshtatshme;
- c. pensioni maksimal të mos tejkaloj dyfishin e pensionit minimal;
- d. Pensionet duhet së paku të përshtaten me trendin e çmimeve.

³ Sigurimi financohet:

- a. nga kontributet e të siguruarit; kur personi i siguruar është i punësuar, punëdhënësi paguan gjysmën e shumës së kontributit;
- b.⁵⁰ nga kontributet e Konfederatës.

⁴ Kontributet e Konfederatës nuk duhet të tejkalojnë gjysmën e shpenzimeve⁵¹.

⁵ Kontributet e Konfederatës do të financohen me përparësi nga të ardhurat neto nga taksa mbi duhanin, nga tatimet mbi pijet e destiluara dhe nga taksa mbi lojrat e fatit.

⁶ ...⁵²

Neni 112a⁵³ Përfitimet shtesë

¹ Konfederata dhe Kanonet do të paguajnë përfitime shtesë nëse sigurimi i pleqërisë, sigurimi i bashkëshortëve mbijetues dhe sigurimi invalidor nuk i mbulon nevojat themelore.

² Ligji përcakton shumën e përfitimeve shtesë dhe përcakton detyrat dhe kompetencat e Konfederatës dhe Kantoneve.

⁴⁹ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

⁵⁰ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

⁵¹ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

⁵² Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

⁵³ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

Neni 112b⁵⁴ Inkurajimi i integritit të personave me aftësi të kufizuar

¹ Konfederata inkurajon integrimin e personave me aftësi të kufizuara me përfitime në para të gatshme dhe në natyrë. Ajo mund të përdorë për këtë qëllim burimet financiare të sigurimit për aftësisë së kufizuar.

² Kantonet promovojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara, në veçanti përmes kontributeve për ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve për t'u siguruar atyre strehim dhe punë.

³ Ligji përcakton objektivat, parimet dhe kriteret për integrimin e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 112c⁵⁵ Ndihma për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara

¹ Kantonet ofrojnë ndihmë në shtëpi dhe kujdes shtëpiak për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

² Konfederata do të mbështes përpjekjet kombëtare për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Ajo mund të përdorë për këtë qëllim burimet financiare të sigurimit të pleqërisë, të bashkëshortëve mbijetues dhe sigurimet invalidore.

Neni 113 Pensionet profesionale

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita për pensionet profesionale.

² Duke vepruar kështu, ajo do të respektoj parimet në vazhdim:

- a. pensionet profesionale të kombinuara me sigurimin e pleqërisë, të bashkëshortëve mbijetues, dhe ata invalidor u mundësojnë të siguruarit të mbajë standardin e mëparshëm të jetesës;
- b. skema e pensioneve profesionale është e detyrueshme për të punësuarit; ligji mund të parashikoj përjashtime;
- c. punëdhënësi siguron punonjësit e tij në një institucion sigurimesh, nëse është e nevojshme, Konfederata i jep mundësinë e sigurimit të punonjësve të tij me fonde federale;
- d. personat e vetëpunësuar mund të sigurohen në një fond pensional në baza vullnetare;
- e. Konfederata mund të deklaroj të detyrueshëm sigurimin e pensioneve profesionale për kategori të caktuara të personave të angazhuar në veprimtari të pavarur, në përgjithësi ose për të mbuluar rreziqe të veçanta.

³ Skema e sigurimit profesional financohet nga kontributet e të siguruarit; kur personi i siguruar është i punësuar, punëdhënësi paguan të paktën gjysmën e shumës së kontributit.

⁴ Institucionet e sigurimeve duhet të plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara nga ligjet federale; Konfederata, mund, me qëllim të zgjidhjes së problemeve të veçanta, të sigurojë masa që zbatohen në të gjithë vendin.

⁵⁴ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

⁵⁵ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

Neni 114 Sigurimi i papunësisë

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita për sigurimin e papunësisë.

² Duke vepruar kështu, ajo do të respektoj parimet në vazhdim:

- a. ky sigurim garanton një kompensim të duhur pas humbjes së të ardhurave dhe mbështet masat për parandalimin dhe luftimin e papunësisë;
- b. sigurimi është i detyrueshëm për punonjësit; ligji mund të parashikoj përjashtime;
- c. personat e vetëpunësuar mund të sigurohen në baza vullnetare.

³ Sigurimi i papunësisë financohet nga kontributet e të siguruarit; kur personi i siguruar është i punësuar, punëdhënësi paguan gjysmën e shumës së kontributit.

⁴ Konfederata dhe Kantonet japin ndihmë financiare në rrethana të jashtëzakonshme.

⁵ Konfederata mund të nxjerr dispozita për ndihmën sociale për të papunët.

Neni 115 Ndhimja për personat me nevojë

Personat me nevojë do të ndihmohen nga Kantoni i vendbanimit të tyre. Konfederata rregullon përjashtimet dhe kompetencen.

Neni 116 Shtesat familjare dhe sigurimi i lindjes

¹ Gjatë kryerjes së detyrave të saj, Konfederata merr parasysh nevojat e familjes. Ajo mund të ndërmarr masa për mbrojtjen e familjes.

² Ajo mund të nxjerrë ligje mbi ndihmat familjare dhe të menaxhojë një fond kompensimi federal për shtesat familjare.

³ Ajo do të themeloj një skemë të sigurimit të lindjes. Ajo gjithashtu, mund të bëjë të detyrueshme kontributin për personat të cilët nuk mund të përfitojnë nga këto sigurime.

⁴ Ajo mund të deklarojë participimin në një fond kompensimi familjar të detyrueshëm dhe në sigurimin e lindjes, përgjithësisht ose për kategori të caktuara të personave, dhe të bëjë përfitimet e tij nga një kontribut i drejtë i Kantoneve.

Neni 117 Sigurimi shëndetësor dhe sigurimi i aksidenteve

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita lidhur me sigurimin shëndetësor dhe sigurimin e aksidenteve.

² Ajo mund të detyrueshëm për të gjithë ose për kategori të caktuara personash sigurimin shëndetësor dhe sigurimin e aksidenteve.

Neni 117^{a56} Kujdesi bazik shëndetësor

¹ Brenda kompetencave të tyre përkatëse, Konfederata dhe Kantonet do të sigurojnë që çdokush të ketë qasje të mjaftueshme dhe adekuate në kujdesin bazik shëndetësor. Ato do t'a njohin mjekësinë familjare si një komponentë thelbësore të kujdesit bazik shëndetësor dhe do t'a inkurajojnë atë.

² Konfederata do të nxjerr dispozita lidhur me:

- a. trajnimin bazik dhe të specializuar në fushën e mjekësisë familjare dhe kushtet e ushtrimit të këtyre profesioneve;

⁵⁶ Panuar me votim popullor të datës 18 maj 2014, hyn në fuqi nga data 18 maj 2014 (Dekreti Federal i datës 19 shtator 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 18 gusht 2014; RO 2014 2769; FF 2010 2679, 2011 6953, 2013 6571, 2014 6121).

b. shpërblimin e duhur të shërbimeve të mjekësisë familjare.

Neni 118 Mbrojtja shëndetësore

¹ Brenda kufijve të saj, Konfederata do të ndërmarr masa për të mbrojtur shëndetin.

² Ajo do të nxjerr dispozita lidhur me:

- a. përdorimin e produkteve ushqimore, si dhe agjentëve terapeutikë, narkotikë, organizma, kimikate dhe sende që mund të përbëjnë rrezik për shëndetin;
- b. kontrollin e sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve e përhapëse dhe sëmundjeve veçanërisht të rrezikshme për njerëzit dhe kafshët;
- c. mbrojtjen kundër rrezatimit jonizues.

Neni 118a⁵⁷ Mjekësia Plotësuese

Brenda kompetencave të tyre Konfederata dhe Kantonet do të sigurojnë, se do të marrin parasysht shqyrtimin e mjekësisë plotësuese.

Neni 118b⁵⁸ Hulimtimi në qeniet njerëzore

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita lidhur me hulumtimin shkencor mbi qeniet njerëzore, përderisa kjo bëhet duke mbrojtur dinjitetin dhe personalitetin njerëzor. Duke vepruar kështu, ajo do të siguroj lirinë e hulumtimit dhe pranon rëndësinë e hulumtimit për shëndetin dhe shoqërinë.

² Ajo to të respektoj parimet e mëposhtme në hulumtimet biologjike dhe mjekësore që përfshijnë njerëzit:

- a. një projekt kërkimor mund të kryhet vetëm nëse pjesëmarrësi ose përfaqësuesi i tij ligjor ka dhënë pëlqimin e informuar; ligji mund të parashikojë përjashtime; refuzimi është i detyrueshëm në çdo rast;
- b. rreziqet dhe kufizimet e atyre që janë të përfshirë në një projekt hulumtimi nuk duhet të jenë joproportionale me dobinë e projektit;
- c. një projekt hulumtimi tek personat pa aftë për të vepruar mund të kryhet vetëm nëse rezultatet ekuivalente nuk mund të merren nga personat me aftësi të veprimit; kur projekti i hulumtimit nuk sjell përfitim të menjëhershëm për personat e pa aftë për të vepruar, rreziqet dhe kufizimet duhet të jenë minimale;
- d. një ekspertizë e pavarur e projektit hulumtues duhet të ketë vërtetuar se mbrojtja e personave pjesëmarrës në këtë projekt është siguruar.

Neni 119 Procesi i lindjes dhe inxhinierisë gjenetike në fushën e njeriut

¹ Qeniet njerëzore duhet të mbrohen nga abuzimi me mjekësinë riprodhuese dhe inxhinierinë gjenetike.

⁵⁷ Panuar me votim popullor të datës 18 maj 2009, hyn në fuqi nga data 17 maj 2009 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 21 tetor 2009; RO 2009 5325; FF 2005 5631, 2006 7191, 2008 7469, 2009 6833).

⁵⁸ Panuar me votim popullor të datës 7 mars 2001, hyn në fuqi nga data 7 mars 2010 (Dekreti Federal i datës 25 shtator 2009, Dekreti i Këshillit Federal i datës 15 prill 2010; RO 2010 1569; FF 2007 6345, 2009 6005, 2010 2397).

² Konfederata do të nxjer dispozita për përdorimin e materialit për riprodhim njerëzor dhe gjenetik. Duke vepruar kështu, ajo do të sigurojë mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, personalitetit dhe familjes duke përfshirë edhe parimet e mëposhtme:

- a. të gjitha format e klonimit dhe ndërhyrjeve në trashëgiminë gjenetike qelizave riprodhuese njerëzore dhe embrioneve janë të jashtëligjshme;
- b. materiali riprodhues dhe gjenetik jo-human nuk mund as të transferohet e as të bashkohet me materialin riprodhues njerëzor;
- c.⁵⁹ përdorimi i metodave të riprodhimit të asistuar është i autorizuar vetëm në rasetet e sterilitetit ose rrezikut të transmetimit të një sëmundje serioze nuk mund të hiqet në një mënyrë tjetër, por jo për të zhvilluar në cilësi të caktuara të fëmijëve ose për të bërë hulumtime; fekondimi i vezëve njerëzore jashtë trupit të gruas lejohet vetëm nën kushtet e parashikuara me ligj; nuk mund të zhvillohen jashtë trupit të gruas qeliza vezë më shumë se që është e nevojshme për riprodhim të asistuar mjekësor;
- d. dhurimi i embrionit dhe të gjitha format e zëvendësimit janë të ndaluara;
- e. materiali riprodhues njerëzor ose produktet që rezultojnë nga embrionet nuk mund të tregtohen;
- f. trashëgimia gjenetike e një personi mund të analizohet, regjistrohet dhe komunikohet vetëm me pëlqimin e atij personi ose përfaqësuesit së tij ligjor;
- g. çdokush ka të drejtë në qasje në të dhënat që kanë të bëjnë me prejardhjen e tij.

Neni 119a⁶⁰ Mjekësia e transplantit

¹ Konfederata do të nxjerrë dispozita në fushën e transplantimit të organeve, indeve dhe qelizave. Duke vepruar kështu, ajo do të siguroj mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, personalitetit dhe shëndetit.

² Ajo të siguroj një shpërndarje të barabartë të organeve.

³ Dhurimi i organeve, indeve dhe qelizave njerëzore është pa pagesë. Tregtia me organet njerëzore është e ndaluar.

Neni 120 Inxhinieria gjenetike në domenin jo njerëzor*

¹ Njerëzit dhe mjedisi i tyre duhet të mbrohen nga abuzimi me inxhinierinë gjenetike.

² Konfederata do të nxjerrë dispozita për përdorimin e materialeve riprodhuese dhe gjenetike të kafshëve, bimëve dhe organizmave të tjerë. Duke vepruar kështu, ajo do të respektoj integritetin e organizmave të gjalla dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe mjedisit dhe mbron diversitetin gjenetik të llojeve të kafshëve dhe bimëve.

⁵⁹ Panuar me votim popullor të datës 14 qershor 2015, hyn në fuqi nga data 14 qershor 2015 (Dekreti Federal i datës 12 dhjetor 2014, Dekreti i Këshillit Federal i datës 21 gusht 2015; RO 2015 2887; FF 2013 5253, 2014 9451, 2015 5777).

⁶⁰ Panuar me votim popullor të datës 7 shkurt 1999, hyn në fuqi nga data 1 janar 2000 (Dekreti Federal i datës 26 qershor 1998, Dekreti i Këshillit Federal i datës 23 mars 1999; RO 1999 1341; FF 1997 III 613, 1998 3059, 1999 2675 7967).

Seksioni 9 Vendqëndrimi dhe statusi e të huajve

Neni 121 Legjislacioni për të huajtë dhe azilin*⁶¹

¹ Legjislacioni për hyrje në Zvicër, dalje, vendbanim dhe vendosje të të huajve dhe dhënie të azilit është çështje e Konfederatës.

² Të huajt që kërcënojnë sigurinë e vendit mund të përjashtohen nga Zvicra.

³ Ata janë të privuar nga leja e qëndrimit, pavarësisht nga statusi dhe të drejtat e tyre për të qëndruar në Zvicër:

a. nëse janë dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vrasje, përdhunim ose ndonjë veprë tjetër të rëndë seksuale, për një akt të dhunës së natyrës të ndryshme, si vjedhje, trafikim me qenie njerëzore, trafik droge ose vjedhje;

b. nëse ata kanë abuzuar me përfitimet nga sigurimet shoqërore ose ndihma sociale⁶².

⁴ Legjvënësi do të specifikoj shkeljet që përbëjnë veprat penale të përmendura në par. 3. Ajo mund t'i plotësojë ato me shkelje tjera⁶³.

⁵ Të huajt që humbin lejën e qëndrimit dhe të gjitha të drejtat e tyre për të qëndruar në Zvicër duhet të largohen nga vendi nga autoritetet kompetente dhe të ndalohen nga hyrja në vend nga 5 deri në 15 vjet. Në rast përsëritje, ndalimi për të hyrë në territor do të caktohet në 20 vjet⁶⁴.

⁶ Të huajt që shkelin ndalimin për të hyrë në territor ose që hyjnë ilegalisht do të dënohen. Ligjvënësi do të miratoj dispozitat përkatëse⁶⁵.

Neni 121a⁶⁶ Imigracioni*

¹ Zvicra menaxhon në mënyrë autonome imigrimin e të huajve.

² Numri i autorizimeve të lëshuara për qëndrim të huajve në Zvicër kufizohet nga kufijtë dhe kuotat vjetore. Kufizimet zbatohen për të gjitha autorizimet e nxjerra sipas ligjit për të huajt, duke përfshirë azilin. E drejta për qëndrim të përhershëm, ribashkim familjar dhe përfitime sociale mund të jetë e kufizuar.

⁶¹ Panuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2014, hyn në fuqi nga data 9 shkurt 2014 (Dekreti Federal i datës 27 shtator 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 maj 2013; RO 2014 1391; FF 2011 5845, 2012 3611, 2012 3611, 2013 279 6575, 2014 3957).

⁶² Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2010, hyn në fuqi nga data 28 nëntor 2010 (Dekreti Federal i datës 28 qershor 2010, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2011; RO 2011 1199; FF 2008 1745, 2009 4571, 2010 3853, 2011 2593).

⁶³ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2010, hyn në fuqi nga data 28 nëntor 2010 (Dekreti Federal i datës 28 qershor 2010, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2011; RO 2011 1199; FF 2008 1745, 2009 4571, 2010 3853, 2011 2593).

⁶⁴ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2010, hyn në fuqi nga data 28 nëntor 2010 (Dekreti Federal i datës 28 qershor 2010, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2011; RO 2011 1199; FF 2008 1745, 2009 4571, 2010 3853, 2011 2593).

⁶⁵ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2010, hyn në fuqi nga data 28 nëntor 2010 (Dekreti Federal i datës 28 qershor 2010, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2011; RO 2011 1199; FF 2008 1745, 2009 4571, 2010 3853, 2011 2593).

⁶⁶ Panuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2014, hyn në fuqi nga data 9 shkurt 2014 (Dekreti Federal i datës 27 shtator 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 maj 2014; RO 2014 1391; FF 2011 5845, 2012 3611, 2013 279 6575, 2014 3957).

³ Kufizimet dhe kuotat vjetore për të huajt e angazhuar në aktivitete fitimprurëse duhet të përcaktohen në përputhje me interesat e përgjithshme ekonomike të Zvicrës dhe në përputhje me parimin e preferencës kombëtare; ato duhet të përfshijnë punonjësit e kufirit. Kriteret vendimtare për dhënien e lejeve të qëndrimit janë në veçanti kërkesa e punëdhënësit, kapaciteti i integritetit dhe burimi i mjaftueshëm dhe autonom i të ardhurave.

⁴ Asnjë marrëveshje ndërkombëtare në kundërshtim me këtë Nen nuk mund të lidhet .

⁵ Me ligji do të rregullohen modalitetet.

Seksioni 10 E drejta civile, e drejta penale, metrologjia

Neni 122⁶⁷ E Drejta Civile

¹ Legjislacioni në fushën e së drejtës civile dhe procedurës civile bie nën juridiksionin e Konfederatës.

² Organizimi gjyqësor dhe administrimi i drejtësisë në fushën e së drejtës civile janë përgjegjësi e Kantoneve, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

Neni 123⁶⁸ E drejta Penale

¹ Legjislacioni për të drejtën penale dhe procedurën penale është nën juridiksionin e Konfederatës.

² Organizimi i gjyqësorit dhe administrimi i drejtësisë, si dhe zbatimi i dënimeve dhe masave në fushën e së drejtës penale janë përgjegjësi e Kantoneve, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

³ Konfederata mund të nxjerrë ligje për ekzekutimin e dënimeve dhe masave. Ajo mund t'i ofroj Kantoneve ndihmë:

- a. për ndërtimin e objekteve;
- b. për përmirësimin e ekzekutimit të dënimeve dhe masave tjera;
- c. për mbështetjen e institucioneve ku kryhen masa edukative për fëmijët, adoleshentët ose të rinjtë⁶⁹.

Neni 123a⁷⁰

¹ Nëse një dhunues seksual përshkruhet si jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe i pandryshueshëm në mendimet e ekspertëve të nevojshëm për gjykim, ai duhet të denohet me burgim të përjetshëm për shkak të rrezikut të lartë të recidivizmit. Lirimi i hershëm dhe lirimi i përkohshëm përjashtohen.

⁶⁷ Panuar me votim popullor të datës 12 mars 2000, hyn në fuqi nga data 1 janar 2007 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 1999, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2000; DKF i datës 8 mars 2005; RO 2002 3148, 2006 1059; FF 1997 I 1, 1999 7831, 2000 2814, 2001 4000).

⁶⁸ Panuar me votim popullor të datës 12 mars 2000, hyn në fuqi nga data 1 janar 2007 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 1999, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2000; DKF i datës 8 mars 2005; RO 2002 3148, 2006 1059; FF 1997 I 1, 1999 7831, 2000 2814, 2001 4000).

⁶⁹ Panuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i datës 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

⁷⁰ Panuar me votim popullor të datës 8 shkurt 2004, hyn në fuqi nga data 8 shkurt 2004 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 21 prill 2004; RO 2004 2341; FF 2000 3124, 2001 3265, 2003 3979, 2004 2045).

² Ekspertizë e re ofrohet vetëm nëse njohuritë e reja shkencore përcaktojnë se i dënuari mund të shërohet dhe nuk përbënë më rrezik për komunitetin. Autoriteti që shqipton heqjen e burgimit në funksion të këtyre ekspertëve është përgjegjës në rast të përsëritjes.

³ Çdo ekspertizë lidhur me kryerësin e veprës përcaktohet nga të paktën dy ekspertë të pavarur të cilët i konsiderojnë të gjitha elementet relevante.

Neni 123b⁷¹ Pa-parashkrueshmeria e ndjekjes penale dhe ndëshkimit të autorëve të veprave penale seksuale ose pornografike me fëmijët e para pubertetit
Procedura penale dhe ndëshkimi për veprat e dënueshme seksuale ose pornografike me fëmijët e moshës së parapubertetit janë të nuk mund të parashkruhen.

Neni 123c⁷² Masat lidhur me veprat seksuale kundër fëmijëve, personave të paaftë për t'u mbrojtur ose për të vepruar
Çdokush i dënuar për shkelje të integritetit seksual të fëmijëve ose të personave të varur, përgjithmonë i heqet e drejta për t'u angazhuar në aktivitete profesionale ose vullnetare që lidhen me të miturit ose personat e varur.

Neni 124 Mbështetja ndaj viktimave
Konfederata dhe Kantonet to të sigurojnë që viktimat e veprave penale të dëmitimit fizik, mendor ose seksual të marrin ndihmë dhe të marrin kompensim të drejtë nëse përjetojnë vështirësi materiale si rezultat i veprës penale.

Neni 125 Metrologjia
Legjislacioni për metrologjinë bie në kompetencë të Konfederatës.

Kapitulli 3 Sistemi i financave

Neni 126⁷³ Menaxhimi i financave

¹ Konfederata do t'i balancoj shpenzimet dhe të ardhurat e saj me kalimin e kohës.

² Tavanet financiare për shpenzimet e përgjithshme që duhet të aprovohen me buxhet përcaktohen në bazë të kursimeve të llogaritura, duke marrë parasysh situatën ekonomike.

³ Nevojat e jashtëzakonshme financiare mund të justifikojnë një rritje të përshtatshme të tavanit të shpenzimeve të përmendura në paragrafët 1 dhe 2. Asambleja Federale vendos për një rritje të tillë në përputhje me Nenin. 159, par. 3, shkronja c.

⁷¹ Panuar me votim popullor të datës 30 nëntor 2008, hyn në fuqi nga data 30 nëntor 2008 (Dekreti Federal i datës 13 qershor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 23 janar 2009; RO 2009 471; FF 2006 3529, 2007 5099, 2008 4749, 2009 499).

⁷² Panuar me votim popullor të datës 18 maj 2014, hyn në fuqi nga data 18 maj 2014 (Dekreti Federal i datës 20 shkurt 2014; RO 2014 2771; FF 2009 6359, 2011 4125, 2012 8151, 2014 6121 1699).

⁷³ Panuar me votim popullor të datës 2 dhjetor 2001, hyn në fuqi nga data 2 dhjetor 2001 (Dekreti Federal i datës 22 qershor 2001, Dekreti i Këshillit Federal i datës 4 shkurt 2002; RO 2002 241; FF 2000 4295, 2001 2255 2741, 2002 1156).

⁴ Nëse shpenzimet e përgjithshme në llogarinë shtetërore e tejkalojnë kufirin e përcaktuar në përputhje me par. 2 ose 3, shpenzimet shtesë do të kompensohen në vitet në vijim.

⁵ Ligji rregullon modalitetet.

Neni 127 Parimet që qeverisin tatimet

¹ Parimet e përgjithshme që rregullojnë sistemin e taksave, duke përfshirë cilësinë e tatueshme, qëllimin e tatimit dhe mënyrën e llogaritjes së tij, do të përcaktohen me ligj.

² Për aq sa natyra e tatimit e lejon, në veçanti, parimet e universalitetit, trajtimit të barabartë dhe kapacitetit ekonomik duhet të respektohen.

³ Ndalohet tatimi i dyfishtë nga Kantonet. Konfederata do të marr masat e nevojshme.

Neni 128 Taksat direkte*

¹ Konfederata mund të vjelë një taksë minimale direkte:

- a. me një normë maksimale prej 11.5% mbi të ardhurat e personave fizikë;
- b.⁷⁴ me një normë maksimale prej 8.5% mbi fitimin neto të personave juridikë;
- c. ...⁷⁵

² Gjatë përcaktimit të tarifave, ajo do të marr parasysh barrën e taksave direkte të Kantoneve dhe Komunave.

³ Lidhur me taksat në të ardhurat e personave privatë, duhet të bëhen rishikime të rregullta për të kompenzuar pasojat e rritjes tatimore për shkak të inflacionit.

⁴ Kantonet kryejnë llogaritjen dhe mbledhjen e tatimeve. Të paktën 17% e të ardhurave bruto të tatimit atyre u alokohen. Kjo përqindje mund të reduktohet deri në 15% për aq kohë sa efektet e barazimit financiar e kërkojnë⁷⁶.

Neni 129 Harmonizimi i taksave

¹ Konfederata do të përcaktoj parimet për harmonizimin e taksave direkte të Konfederatës, Kantoneve dhe Komunave; ajo do të marr parasysh përpjekjet e Kantoneve për harmonizim.

² Harmonizimi shtrihet në objektin, periudhën e llogaritjes së tatimit, procedurës dhe ligjit penal në çështjet tatimore. Shkallët, normat dhe shumat e përjashtuara nga taksat, në veçanti, nuk janë subjekt i harmonizimit të taksave.

³ Konfederata mund të nxjerrë ligje për të luftuar dhënien e përfitimeve tatimore të pajustificuara.

⁷⁴ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

⁷⁵ Shfuqizuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, me efekt nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

⁷⁶ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

Neni 130⁷⁷ Tatimi mbi vlerën e shtuar*

¹ Konfederata mund të vendosë një taksë mbi vlerën e shtuar me një normë normale deri prej 6.5% dhe një normë të reduktuar prej së paku 2.0%, për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë përfitimet për veten, si dhe për importet.

² Për tatimin e përfitimeve nga sektori i akomodimit, ligji mund të përcaktojë një normë më të ulët se norma normale dhe mbi normën e reduktuar⁷⁸.

³ Nëse, si rrjedhojë e ndryshimeve demografike, financimi i sigurimit të pleqërisë, bashkëshortëve mbijetues dhe personave me aftësi të kufizuara nuk është më i siguruar, Konfederata me një ligj federal mund t'a rrisë normën me jo më shumë se 1 pikë përqindjeje dhe tatimi normal i vlerës së shtuar me 0.3 pikë përqindje në normën më të ulët⁷⁹.

^{3bis} Me qëllim të financimit të infrastrukturës hekurudhore, norma do të rritet me 0.1 pikë përqindje⁸⁰.

⁴ 5% e të ardhurave do përdoren për të reduktuar premiumet e sigurimit shëndetësor për personat me të ardhura më të ulëta, përveç nëse ligji e përcakton forma tjera të ndihmës ndaj këtyre personave.

Neni 131 Taksat për konsum special*

¹ Konfederata mund të vendosë një taksë të veçantë të konsumit për mallrat në vijim:

- a. duhan të papërpunuar dhe duhan të prodhuar;
- b. pije të distiluara;
- c. birra;
- d. automobilat dhe komponentët e tyre;
- e. naftës, vajrave të tjera minerale, gazit natyror, produkteve që rezultojnë nga rafinimi i tyre dhe lëndët djegëse.

² Ajo gjithashtu mund të mbledhë:

- a. një mbitaksë në taksën për karburant, me përjashtim të karburanteve për aviacion;
- b. një tarifë për përdorimin e automjeteve tjera të cilat funksionojnë me mënyra tjera nga ato të karburanteve motorike në pajtim me par. 1, shkronja e⁸¹.

⁷⁷ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

⁷⁸ Që nga 1 janari 2018 deri më së voni më 31 dhjetor 2027, tatimet nga sektori i akomodimit do të jetë 3.7 % (Neni 25 par. 4 e Ligjit federal të dates 12 qershor 2009 për TVSH; RS 641.20)

⁷⁹ Që nga 1 janari 2018 deri më së voni më 31 dhjetor 2030, vlera e zakonshme për tatimin mbi vlerën e shtuar do të jetë 7.7% kurse vlera e reduktuar 2.5% (Neni 25, par. 1 dhe 2 të Ligjit federal të dates 12 qershor 2009 për TVSH; RS 641.20).

⁸⁰ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2014, hyn në fuqi nga data 1 janar 2016 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 maj 2014; DKF i dates 6 qershor 2014; RO 2015 645; FF 2010 6049 5225, 2012 1371, 2013 4191 5872, 2014 3953 3957).

⁸¹ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2017 (Dekreti Federal i datës 30 shtator 2016, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 prill 2017; RO 2017 2643; FF 2015 739 1253; 2017 3213).

^{2bis} Nëse mjetet financiare për kryerjen e detyrave që kanë të bëjnë me trafikun ajror që janë parashikuar me Nenin 87b janë të pamjaftueshme, Konfederata do të vjelë një taksë shtesë mbi taksën e konsumit të karburanteve të aviacionit⁸².

³ Një e dhjeta e të ardhurave neto të tatimit mbi pije të distiluara u paguhen Kantoneve. Keto fonde do të përdoren për të luftuar shkaqet dhe efektet e varësisë ndaj substancave.

Neni 132 Dhënia e vulës dhe tatimi në burim

¹ Konfederata mund të vendosë taksë për dhënien e vulës për letrat me vlerë, në faturat e premieeve të sigurimeve dhe në aktivitete tjera komerciale; letrat me vlerë në lidhje me pasuritë e paluajtshme dhe transaksionet hipotekare janë të liruara nga detyrimet e vulës.

² Konfederata mund të vendosë një taksë në burim nga të ardhurave nga pasuritë e luajtshme kapitale, fitimet nga lojrat e fatit dhe mbi përfitimet nga sigurimet. 10% e të ardhurave do t'u ndahen Kantoneve⁸³.

Neni 133 Detyrat doganore

Legjislacioni për detyrimet doganore dhe detyrimet tjera për lëvizjen e mallrave është përgjegjësi e Konfederatës.

Neni 134 Përfshirja nga taksat kantonale dhe komunale

Subjektet që i nënshtrohen tatimit mbi vlerën e shtuar, taksat e konsumit të veçantë, detyrimet e pullës ose tatimit në burim, ose që deklaron të përfshirë nga Konfederata, nuk mund të tatimohen për të njëjtat nga Kantonet ose Komunitet.

Neni 135⁸⁴ Barazimi financiar dhe kompensimi i shpenzimeve

¹ Konfederata do të nxjerr dispozita lidhur me barazimin financiar dhe kompensimin e shpenzimeve të përshtatshme midis Konfederatës dhe Kantoneve nga njëra anë, dhe midis Kantoneve nga ana tjetër.

² Qëllimet e barazimit financiar dhe kompensimit të shpenzimeve janë:

- a. zvogëlimi i pabarazive në mes të Kantoneve sa i përket kapacitetit financiar;
- b. t'i garantohet Kantoneve një alokim minimal të burimeve financiare;
- c. për të kompensuar kostot e larta të Kantoneve për shkak të faktorëve gjeo-topografikë ose socio-demografikë;
- d. për të promovuar bashkëpunimin ndër-kantonale me kompensim për shpenzimet;
- e. të mbajë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar konkurrencën fiskale të Kantoneve.

⁸² Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2017 (Dekreti Federal i datës 30 shtator 2016, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 prill 2017; RO 2017 2643; FF 2015 739 1253; 2017 3213).

⁸³ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i datës 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

⁸⁴ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i datës 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

³ Barazimi i burimeve financohet nga Kantonet me potencial të lartë resursesh dhe nga Konfederata. Kontributet e Kantoneve me potencial të lartë të resurseve janë ekuivalente me të paktën dy të tretat dhe më së shumti 80% e kontributeve të bëra nga Konfederata.

Titulli 4 Populli dhe Kantonet

Kapitulli 1 Dispozitat e përgjithshme

Neni 136 Të drejtat politike

¹ Të gjithë shtetasit zviceranë mbi moshën 18 vjeç, nëse nuk e kanë të ndaluar për shkak të sëmundjes mendore ose vonesës mendore kanë të drejta politike në çështjet federale. Të gjithë kanë të njëjtat të drejta dhe detyra politike.

² Ata mund të marrin pjesë në zgjedhjen e Këshillit Kombëtar dhe në zgjedhjet federale dhe të iniciojnë apo të nënshkruajnë iniciativa popullore dhe të kërkojnë referendum për çështjet federale.

Neni 137 Partitë politike

Partitë politike do të kontribuojnë në formimin e mendimit dhe vullnetit popullit.

Kapitulli 2 Iniciativa popullore dhe referendumi

Neni 138 Iniciativa popullore për rishikimin e plotë të Kushtetutës

¹ 100 000 shtetas që kanë të drejtën e votës, brenda një afati prej 18 muajve nga botimi zyrtar i iniciativës së tyre, mund të propozojnë rishikimin e plotë të Kushtetutës⁸⁵.

² Ky propozim dorëzohet për nga Populli.

Neni 139⁸⁶ Iniciativa e Popullore për rishikimin e pjesshëm të Kushtetutës

¹ 100.000 shtetas me të drejtë vote, brenda një afati prej 18 muaj nga publikimi zyrtar i iniciativës së tyre, mund të kërkojnë rishikimin e pjesshëm të Kushtetutës.

² Iniciativat popullore që synojnë rishikimin e pjesshëm të Kushtetutës mund të marrin formën e një propozimi të konceptuar në terma të përgjithshëm ose të një teksti të hartuar.

³ Nëse një iniciativë popullore nuk respekton parimin e unifikimit të formës, unifikimit të çështjes ose nëse shkel rregullat me karakter të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare, Asambleja Federale e deklaron atë të pavlefshëm tërësisht ose pjesërisht.

⁴ Nëse Asambleja Federale miraton një iniciativë popullore të konceptuar në terma të përgjithshëm, ajo do të përgatis rishikimin e pjesshëm në bazë të iniciativës dhe e paraqet atë për votimin nga

⁸⁵ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003, hyn në fuqi nga data 1 gusht 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; DKF i datës 19 qershor 2003; RO 2003 1949; FF 2001 4590 5783, 2002 6026; 2003 2784 3518 3225).

⁸⁶ Pranuar me votim popullor të datës 27 shtator 2003, hyn në fuqi nga data 27 shtator 2009 (Dekreti Federal i datës 19 dhjetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 1 dhjetor 2009; RO 2009 6409; FF 2008 2549 2565, 2009 19 7889).

Populli dhe Kantonet. Nëse Asambleja Federale kundërshton iniciativën, ajo e paraqet atë për votim nga Populli, i cili vendos nëse ajo duhet të pranohet dhe adoptohet. Në rast të pranimin nga Populli, Asambleja Federale harton projektin e kërkuar nga iniciativa.

⁵ Çdo iniciativë në formën e një drafti paraqitet për votim nga Populli dhe Kantonet. Asambleja Federale rekomandon pranimin ose refuzimin e saj. Iniciativës mund t'i paraqitet një kundërprojekt.

Neni 139a⁸⁷

Neni 139b⁸⁸ Procedurat e zbatueshme për votim të një iniciative dhe kundërprojektit

¹ Qytetarët me të drejtë drejtë vote, votojnë njëkohësisht për iniciativën dhe kundërprojektin⁸⁹.

² Ata mund të miratojnë të dy projektet në të njëjtën kohë. Ata mund të tregojnë, në përgjigje të pyetjes plotësuese, projektin për të cilin ata preferojnë në rast se të dyja projektet janë pranuar.

³ Sa i përket amendamenteve kushtetuese që janë miratuar, nëse në përgjigje të pyetjes plotësuese, një nga projektet merr shumicën e votave të Popullit dhe tjetra shumicën e votave të Kantoneve, projekti që hyn në fuqi është ai që në përgjigje të pyetjes plotësuese, shënoi shumën më të madhe të përqindjes së votave të Popullit dhe votave të Kantoneve.

Neni 140 Referendumi i obligativ

¹ Votimit të Popullit dhe i Kantoneve i nënshtrohen:

- a. rishikimet të Kushtetutës;
- b. anëtarësimi në organizatat kolektive të sigurisë ose komunitetet ndërkombëtare;
- c. ligjet federale të shpallura urgjente që nuk kanë bazë kushtetuese dhe janë të vlefshme për më shumë se një vit; këto ligje duhet të vihen në votim brenda një viti nga miratimi i tyre nga Asambleja Federale.

² Subjekt i votimit të Popullit janë:

- a. iniciativat popullore që synojnë rishikimin e plotë të Kushtetutës;
- a^{bis} ...⁹⁰

⁸⁷ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; RO 2003 1949; FF 2001 4590 5783, 2002 6026, 2003 2784). Shfuqizuar me votim popullor të datës 27 shtator 2009 (Dekreti Federal i datës 19 dhjetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 1 dhjetor 2009; RO 2009 6409; FF 2008 2549 2565, 2009 19 7889). Duke u bazuar në Dekretin Federal të datës 4 tetor 2002 nuk është fuqizuar asnjëherë.

⁸⁸ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003, hyn në fuqi për paragrafët 2 dhe 3 nga data 1 gusht 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; RO 2003 1949; FF 2001 4590 5783, 2002 6026, 2003 2784).

⁸⁹ Pranuar me votim popullor të datës 27 shtator 2003, hyn në fuqi nga data 27 shtator 2009 (Dekreti Federal i datës 19 dhjetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 1 dhjetor 2009; RO 2009 6409; FF 2008 2549 2565, 2009 19 7889).

⁹⁰ Pranuar me votim popullor të datës 27 shtator 2003, hyn në fuqi nga data 27 shtator 2009 (Dekreti Federal i datës 19 dhjetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 1 dhjetor 2009; RO 2009 6409; FF 2008 2549 2565, 2009 19 7889). Duke u bazuar në Dekretin Federal të datës 4 tetor 2002 nuk është fuqizuar asnjëherë.

- b. iniciativat popullore të konceptuara në terma të përgjithshëm që kanë tendencën e rishikimit të pjesshëm të Kushtetutës dhe të cilat janë refuzuar nga Asambleja Federale⁹¹;
- d. rishikimi i plotë i Kushtetutës, në rast mosmarrëveshje në mes të dy këshillave.

Neni 141 Referendumi fakultativ

¹ Nëse 50,000 qytetarë që kanë të drejtën e votës ose tetë Kantone e kërkojnë atë brenda 100 ditëve nga publikimi zyrtar i aktit, ata i nënshtrohen votimit të popullit.⁹²

- a. ligjet federale;
- b. ligjet federale të shpallura urgjente me një vlefshmëri prej më shumë se një viti;
- c. urdhërat federale, në masën që Kushtetuta ose ligji parashikon;
- d. traktatet ndërkombëtare që:
 1. janë me kohëzgjatje të pacaktuar dhe nuk mund të shkëputen,
 2. sigurojnë anëtarësimin në një organizate ndërkombëtare,
 - 3.⁹³ përmbajnë dispozita të rëndësishme që përcaktojnë rregullat ligjore ose zbatimin e të cilave kërkon miratimin e ligjeve federale.

² ...⁹⁴

Neni 141a⁹⁵ Zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare

¹ Kur dekreti i miratimit të një traktati ndërkombëtar i nënshtrohet referendumit të detyrueshëm, Asambleja Federale mund të inkorporojë në vendimin për ratifikim amandamentet kushtetuese lidhur me zbatimin e traktatit.

² Kur dekreti i miratimit të një traktati ndërkombëtar i nënshtrohet referendumit fakultativ, Asambleja Federale mund të inkorporojë në vendimin për ratifikim ndryshimet e ligjeve që lidhen me zbatimin e traktatit.

Neni 142 Shumica e kërkuar

¹ Aktet e paraqitura për votim nga Populli pranohen nga shumica e votuesve.

⁹¹ Pranuar me votim popullor të datës 27 shtator 2003, hyn në fuqi nga data 27 shtator 2009 (Dekreti Federal i datës 19 dhjetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 1 dhjetor 2009; RO **2009** 6409; FF **2008** 2549 2565, **2009** 19 7889).

⁹² Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003, hyn në fuqi nga data 1 gusht 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; DKF i datës 19 qershor 2003; RO **2003** 1949; FF **2001** 4590 5783, **2002** 6026; **2003** 2784 3518 3225).

⁹³ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003, hyn në fuqi nga data 1 gusht 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; DKF i datës 19 qershor 2003; RO **2003** 1949; FF **2001** 4590 5783, **2002** 6026; **2003** 2784 3518 3225).

⁹⁴ E shfuqizuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003, me efekt nga data 1 gusht 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; DKF i datës 19 qershor 2003; RO **2003** 1949; FF **2001** 4590 5783, **2002** 6026; **2003** 2784 3518 3225).

⁹⁵ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003, hyn në fuqi nga data 1 gusht 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; DKF i datës 19 qershor 2003; RO **2003** 1949; FF **2001** 4590 5783, **2002** 6026; **2003** 2784).

² Aktet e paraqitura për votim nga Populli dhe Kantonet pranohen kur shumica e votuesve dhe shumica e Kantoneve i miratojnë ato.

³ Rezultati i votimit popullor në një Kanton është zëri i Kantonit.

⁴ Kantonet e Obwalden, Nidwalden, Basel-qytet, Basel-rrethinë, Appenzell Ausserrhoden dhe Appenzell Innerrhoden kanë secili gjysmë vote.

Titulli 5 Autoritetet federale

Kapitulli 1 Dispozitat e përgjithshme

Neni 143 E drejta për t'u zgjedhur

Çdo qytetar që ka të drejtën e votës ka të drejtë për t'u zgjedhur në Këshillin Kombëtar, Këshillin Federal dhe Gjykatën Supreme Federale.

Neni 144 Mospërputhshmëritë

¹ Një anëtar i Këshillit Kombëtar, Këshillit të Shteteve, Këshillit Federal dhe një gjyqtar në Gjykatën Federale nuk mund të kryejnë në të njëjtën kohe funksione në më shumë se një nga organet e lartpërmendura.

² Anëtarët e Këshillit Federal, si dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme Federale që punojnë me orar të plotë, nuk mund të mbajnë ndonjë funksion tjetër në shërbim të Konfederatës ose të ndonjë Kantoni, ose të angazhohen në ndonjë aktivitet tjetër fitimprurës.

³ Ligji mund të parashikojë mospërputhje të tjera.

Neni 145 Kohëzgjatja e mandatit

Anëtarët e Këshillit Kombëtar dhe Këshillit Federal si dhe Kancelari i Konfederatës zgjidhen për një mandat katër vjeçar. Gjyqtarët në Gjykatën Supreme Federale zgjidhen për një mandat gjashtë vjeçar.

Neni 146 Përgjegjësia e shtetërore

Konfederata do të përgjigjet për dëmet ose humbjet të shkaktuara nga organet e saj gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 147 Procedura e konsultimit

Kantonet, partitë politike dhe palët e interesuara do të ftohen për të shprehur pikëpamjet e tyre gjatë hartimit të akteve të rëndësishme legislative dhe projekteve të tjera të një rëndësie të madhe, si dhe për traktatet e rëndësishme ndërkombëtare.

Kapitulli 2 Asamblea federale

Seksioni 1 Organizimi

Neni 148 Roli i Asamblesë Federale

¹ Asambleja Federale është autoriteti suprem i Konfederatës, në varësi të të drejtave të Popullit dhe Kantoneve.

² Ajo përbëhet nga dy dhoma, Këshilli Kombëtar dhe Këshilli i Shteteve, me të njëjtat kompetenca.

Neni 149 Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit Kombëtar

¹ Këshilli Kombëtar përbëhet nga 200 deputetë të Popullit.

² Deputetët zgjedhen nga Populli me votim të drejtpërdrejtë sipas sistemit proporcional. Këshilli Kombëtar zgjedhet në çdo katër vjet.

³ Çdo Kanton përbënë një zonë elektorale zgjedhore.

⁴ Kantoneve vendet u ndahen në përpjesëtim me popullsinë e tyre. Çdo Kanton ka të drejtë të ketë së paku një vend.

Neni 150 Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit të Shteteve

¹ Këshilli i Shteteve përbëhet nga 46 deputetë nga që vijnë nga Kantonet.

² Kantonet e Obwalden, Nidwalden, Basel-qtet, Basel-rrethinë, Appenzell Ausserrhoden dhe Appenzell Innerrhoden do të përfaqësohen me nga një deputet secili; Kantonet tjera do të përfaqësohen me nga dy deputetë.

³ Kantonet miratojnë rregullat e zbatueshme për zgjedhjen e deputetëve të tyre në Këshillin e Shteteve.

Neni 151 Seancat

¹ Këshillat takohen rregullisht. Ligji rregullon majtjen e seancave.

² Një e katërta e anëtarëve të këshillave ose Këshilli Federal mund të kërkojnë mbledhjen e këshillave në një seancë të jashtëzakonshme.

Neni 152 Kryesia

Secili këshill zgjedh për një vit një nga anëtarët e saj për Kryesues, së bashku me zëvendëskryesuesin e parë dhe zëvendëskryesuesin e dytë. Rizgjedhja për mandatin e ardhshëm nuk lejohet.

Neni 153 Komisionet parlamentare

¹ Çdo këshill formon komisione brenda tij.

² Me ligj mund të parashihet themelimi i komisioneve të përbashkëta.

³ Ligji mund të delegojë kompetenca të caktuara tek komisionet, me përjashtim të kompetencave legjislativë.

⁴ Për të kryer detyrat e tyre, komisionet kanë të drejtë të jenë të informuara, të konsultojnë dokumente dhe të kryejnë hetime. Ligji përcakton kufijtë e kësaj të drejte.

Neni 154 Grupet parlamentare
Anëtarët e Asamblesë Federale mund të formojnë grupe parlamentare.

Neni 155 Shërbimet parlamentare
Asambleja Federale ka shërbimet e saj parlamentare. Ajo mund të përdorë shërbimet e administratës federale. Ligji rregullon modalitetet.

Seksioni 2 Procedura

Neni 156 Seancat e ndara

¹ Këshilli Kombëtar dhe Këshilli i Shteteve funksionojnë në seanca të ndara.

² Vendimet e Asamblesë Federale kërkojnë miratimin e dy dhomave.

³ Ligji duhet të parasheh që në rast të mospajtimeve midis dy dhomave, të merren vendime lidhje me:

- a. vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e pjesshme të një iniciative popullore;
- b. zbatimin e një iniciative popullore të konceptuar në terma të përgjithshëm dhe të miratuar nga Populli⁹⁶;
- c. zbatimin e një dekreti federal të miratuar nga Populli që synon një rishikim të plotë të Kushtetutës⁹⁷;
- d. buxhetin ose amandamentet e tij.⁹⁸

Neni 157 Seancat e përbashkëta

¹ Këshilli Kombëtar dhe Këshilli i Shteteve mbajnë seanca të përbashkëta nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit Kombëtar lidhur me:

- a. mbajtjen e zgjedhjeve;
- b. vendosjen mbi konfliktet e juridiksionit ndërmjet autoriteteve supreme federale;
- c. vendosjen mbi peticionet për falje.

² Përveç kësaj, seanca të përbashkëta mbahen në raste të veçanta dhe për dëgjimin e deklaratave nga anëtarët e Këshilli Federal.

Neni 158 Publiciteti i takimeve

Takimet e këshillave janë publike. Ligji mund të parashikojë përjashtime.

⁹⁶ Pranuar me votim popullor të datës 27 shtator 2003, hyn në fuqi nga data 27 shtator 2009 (Dekreti Federal i datës 19 dhjetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 1 dhjetor 2009; RO **2009** 6409; FF **2008** 2549 2565, **2009** 19 7889).

⁹⁷ Pranuar me votim popullor të datës 27 shtator 2003, hyn në fuqi nga data 27 shtator 2009 (Dekreti Federal i datës 19 dhjetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 1 dhjetor 2009; RO **2009** 6409; FF **2008** 2549 2565, **2009** 19 7889).

⁹⁸ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003, hyn në fuqi nga data 1 gusht 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; DKF i datës 19 qershor 2003; RO **2003** 1949; FF **2001** 4590 5783, **2002** 6026; **2003** 2784 3518 3225).

Neni 159 Kuorumi dhe shumica

¹ Këshillat kanë kuorum vetëm nëse është e pranishme shumica e anëtarëve të tyre.

² Vendimet merren nga shumica e votuesve, qofshin ato seanca të ndara apo të përbashkëta.

³ Megjithatë, nga shumica absolute e anëtarëve të secilit këshill duhet të miratohen:

a. deklarata e urgjencës së ligjeve federale;

b. dispozitat lidhur me grantet, garancitë financiare dhe kufijtë e shpenzimeve, nëse ato përfshijnë shpenzime të reja në shumë prej së paku 20 milionë franga ose shpenzime tjera të reja në shumë prej së paku 2 milionë franga;

c.⁹⁹ rritja e shpenzimeve të përgjithshme në rast të nevojave të jashtëzakonshme financiare të paraparë me Nenin 126, par. 3.

⁴ Asambleja Federale mund të rregullojë shpenzimet e përgjithshme në rastet e jashtëzakonshme financiare të parapara me par. 3, shkronja b.¹⁰⁰

Neni 160 E drejta e iniciativës dhe e drejta e propozimit

¹ Çdo anëtar i Asamblesë Federale, çdo grup parlamentar, çdo komision parlamentar dhe çdo Kanton mund të paraqesë një iniciativë në Asamblenë Federale.

² Anëtarët e këshillit dhe të Këshilli Federal mund të bëjnë propozime në lidhje me një objekt që po diskutohet.

Neni 161 Ndalimi i udhëzimeve lidhur me votim

¹ Anëtarët e Asamblesë Federale votojnë pa udhëzime nga të tjerët.

² Ata bëjnë publike lidhjet që kanë me grupet e interesit.

Neni 162 Imuniteti

¹ Anëtarët e Asamblesë Federale dhe të Këshillit Federal, si dhe Kancelari i Konfederatës Zvicerane, nuk kanë ndonjë përgjegjësi ligjore për deklarimet e tyre në Asamble dhe organet e saj.

² Ligji mund të parashikojë forma të tjera të imunitetit dhe t'i shtrijë ato tek personat e tjerë.

Seksioni 3 Kompetencat**Neni 163** Forma e akteve të miratuara nga Asambleja Federale

¹ Asambleja Federale miraton dispozita që përcaktojnë rregullat në fuqi në formë ligjit apo urdhëresave federale.

² Aktet e tjera miratohen në formën e një dekreti federal, i cili, nëse nuk është subjekt i referendumit, përshkruhet si një dekret i thjeshtë federal.

⁹⁹ Panuar me votim popullor të datës 2 dhjetor 2001, hyn në fuqi nga data 2 dhjetor 2001 (Dekreti Federal i datës 22 qershor 2001, Dekreti i Këshillit Federal i datës 4 shkurt 2002; RO 2002 241; FF 2000 4295, 2001 2255 2741, 2002 1156).

¹⁰⁰ Panuar me votim popullor të datës 2 dhjetor 2001, hyn në fuqi nga data 2 dhjetor 2001 (Dekreti Federal i datës 22 qershor 2001, Dekreti i Këshillit Federal i datës 4 shkurt 2002; RO 2002 241; FF 2000 4295, 2001 2255 2741, 2002 1156).

Neni 164 Legjislacioni

¹ Të gjitha dispozitat e rëndësishme që vendosin rregullat e së drejtës duhet të miratohen në formën e ligjit federal. Kjo kategori ndër të tjera përfshin dispozitat themelore që lidhen me:

- a. ushtrimin e të drejtave politike;
- b. kufizimin e të drejtave kushtetuese;
- c. të drejtat dhe detyrimet e individëve;
- d. statusi i tatimpaguesve, qëllimi i tatimeve dhe llogaritja e shumës së tatimeve;
- e. detyrat dhe shërbimet e Konfederatës;
- f. detyrimet e Kantoneve në zbatimin e së drejtës federale;
- g. organizimin dhe procedurat e autoriteteve federale.

² Ligji federal mund të parashohë delegimin e kompetencave për të nxjerrë rregulla të ligjore, përveç nëse Kushtetuta e përjashton atë.

Neni 165 Legjislacioni urgjent

¹ Ligjet federale, hyrja në fuqi e të cilave nuk mund të vonohet (aktet federale urgjente), mund të shpallen urgjente dhe të hyjnë në fuqi menjëherë me vendim të shumicës absolute të anëtarëve të secilit këshill. Vlefshmëria e tyre duhet të jetë e kufizuar në kohë.

² Nëse kërkohet një referendum për një ligj federal të shpallur urgjent, ato pushojnë së ekzistuari një vit pas miratimit të tij nga ana e Asamblesë Federale nëse nuk është pranuar nga Populli brenda kësaj periudhe.

³ Kur një ligj federal i shpallur urgjent nuk ka një bazë kushtetuese, ai pushon së ekzistuari një vit pas miratimit të tij nga ana e Asamblesë Federale nëse brenda kësaj periudhe nuk është pranuar nga Populli dhe Kantonet. Vlefshmëria e tij duhet të jetë e kufizuar në kohë.

⁴ Një ligj urgjent federal që nuk është pranuar me votim popullor nuk mund të mbetet në fuqi.

Neni 166 Marrëdhëniet me vendet e huaja dhe marrëveshjet ndërkombëtare

¹ Asambleja Federale merr pjesë në përcaktimin e politikës së jashtme dhe monitoron marrëdhëniet me vendet e huaja.

² Ajo do të ratifikoj marrëveshjet ndërkombëtare, me përjashtim të atyre që janë lidhur nga Këshilli Federal në bazë të një ligji ose traktati ndërkombëtar.

Neni 167 Financat

Asambleja Federale voton shpenzimet e Konfederatës, vendos buxhetin dhe miraton llogaritë e shtetit.

Neni 168 Zgjedhjet

¹ Asambleja Federale zgjedh anëtarët e Këshillit Federal, Kancelarin e Konfederatës, gjyqtarët e Gjykatës Supreme Federale si dhe në kohë lufte zgjedh Komandantin e përgjithshëm të forcave të armatosura.

² Ligji mund t'i japë Asamblesë Federale të drektën për të zgjedhur ose konfirmuar zgjedhjen e personave të tjerë.

Neni 169 Roli mbikëqyrës

¹ Asambleja Federale ushtron rol mbikëqyrës ndaj Këshillit Federal dhe Administratës Federale, Gjykatave Federale dhe organeve ose personave të tjerë të ngarkuar me detyrat e Konfederatës.

² Parimi i fshehtësisë zyrtare nuk mund të zbatohet në marrëdhëniet me komisionet mbikëqyrëse të parashikuara me ligj.

Neni 170 Vlerësimi i efektivitetit

Asambleja Federale do të siguroj që efektet e masave të marra nga Konfederata janë vlerësuar.

Neni 171 Mandati Këshillit Federal

Asambleja Federale mund t'i besojë funksione Këshillit Federal. Ligji rregullon modalitetet dhe përcakton në veçanti mjetet me anë të të cilave Asambleja Federale mund të ndërhyjë në fushat që bien në kompetencë të Këshillit Federal.

Neni 172 Marrëdhëniet ndërmjet Konfederatës dhe Kantoneve

¹ Asambleja Federale do të siguroj mbajtjen e marrëdhënieve të mira ndërmjet Konfederatës dhe Kantoneve.

² Ajo do të garantoj kushtetutat kantonale.

³ Ajo do të vendos nëse miratoj ose jo marrëveshjet ndër-kantonale dhe marrëveshjet në mes Kantoneve dhe një vendi të huaj, kur Këshilli Federal ose një Kanton e kërkon këtë.

Neni 173 Detyrat dhe kompetencat tjera

¹ Asambleja Federale ka këto detyra dhe kompetenca shtesë:

- a. ajo merr masat e nevojshme për të ruajtur sigurinë e jashtme, pavarësinë dhe neutralitetin e Zvicrës;
- b. merr masat e nevojshme për të ruajtur sigurinë e brendshme;
- c. kur rrethanat e jashtëzakonshme e kërkojnë këtë dhe në mënyrë që të kryejnë detyrat e përmendura në shkronjat "a" dhe "b", ajo mund të nxjerrë urdhra të thjeshtë federalë ose urdhra;
- d. rregullon shërbimin aktiv dhe, për këtë qëllim, vendos ushtrinë ose një pjesë të ushtrisë;
- e. merr masa për të siguruar zbatimin e së drejtës federale;
- f. trajton vlefshmërinë e iniciativave të suksesshme popullore;
- g. merr pjesë në planifikimin aktivitetëve të rëndësishme të shtetit;
- h. trajton akte të veçanta kur një ligj federal parashikon shprehimisht atë;
- i. zgjedh konfliktet e juridiksionit midis autoriteteve supreme federale;
- k. trajton kërkesat për falje dhe shqipton amnistinë.

² Asambleja Federale gjithashtu merret me të gjitha çështjet që bien në kompetencë të Konfederatës dhe që nuk i përkasin një autoriteti tjetër federal.

³ Ligji mund t'i besojë Asamblesë Federale detyra dhe kompetenca e tjera.

Kapitulli 3 Këshilli federal dhe administrata federale

Sekcioni 1 Organizimi dhe procedurat

Neni 174 Roli i Këshillit Federal

Këshilli Federal është autoriteti më i lartë drejtues dhe ekzekutiv i Konfederatës.

Neni 175 Përbërja dhe zgjedhja

¹ Këshilli Federal përbëhet nga shtatë anëtarë.

² Anëtarët e Këshillit Federal zgjedhen nga Asambleja Federale pas çdo zgjedhje të Këshillit Kombëtar.

³ Ata emërohen për një mandat katër vjeçar dhe zgjedhen nga shtetasit zviceranë që kanë të drejtë të zgjedhen në Këshillin Kombëtar¹⁰¹.

⁴ Rajonet e ndryshme dhe komunitetet gjuhësore duhet të jenë të përfaqësuara mjaftueshëm në Këshillin Federal.¹⁰²

Neni 176 Kryesia

¹ Këshilli Federal kryesohet nga Presidenti i Konfederatës.

² Asambleja Federale zgjedh për një mandat një vjeçar njërin prej anëtarëve e Këshillit Federal si President të Konfederatës dhe një tjetër për Nën President të Këshillit Federal.

³ Këto mandate nuk janë të ripërtëritshme për vitin që pason. Presidenti që largohet nuk mund të zgjidhet Nën President.

Neni 177 Parimi i autoritetit kolegjal dhe ndarja në departamente

¹ Këshilli federal merr vendime në cilësinë e trupit kolegjal.

² Për përgatitjen dhe ekzekutimin e vendimeve, punët e Këshillit Federal ndahen në ndërmjet e anëtarëve të tij sipas departamentit.

³ Kryerja e detyrave mund t'u besohet departamenteve ose njësisive administrative nën vartësi të tyre; e drejta në ankesë duhet të garantohet.

Neni 178 Administrata Federale

¹ Këshilli federal kryeson administratën federale. Ai siguron organizimin racional të saj dhe siguron ekzekutimin e duhur të detyrave që i janë besuar.

² Administrata federale është e ndarë në departamente, secili departament kryesohet nga një anëtar i Këshillit Federal.

³ Me ligj mund t'u besohen detyra të administratës organeve dhe personave të së drejtës publike ose private që janë jashtë administratës federale.

¹⁰¹ Panuar me votim popullor të datës 7 shkurt 1999, hyn në fuqi nga data 1 janar 2000 (Dekreti Federal i datës 26 qershor 1998, Dekreti i Këshillit Federal i datës 23 mars 1999; RO **1999** 1341; FF **1997** III 613, **1998** 3059, **1999** 2675 7967).

¹⁰² Panuar me votim popullor të datës 7 shkurt 1999, hyn në fuqi nga data 1 janar 2000 (Dekreti Federal i datës 26 qershor 1998, Dekreti i Këshillit Federal i datës 23 mars 1999; RO **1999** 1341; FF **1997** III 613, **1998** 3059, **1999** 2675 7967).

Neni 179 Kancelaria Federale

Kancelaria Federale është zyra e përgjithshme administrative e Këshillit Federal. Ajo drejtohet nga Kancelari i Konfederatës.

Seksioni 2 Kompetencat**Neni 180** Politikat qeverisëse

¹ Këshilli Federal përcakton objektivat e qeverisë federale dhe mjetet me të cilat ato duhet të arrihen. Ai planifikon dhe kordinon aktivitetet shtetërore.

² Ajo informon publikun lidhur me veprimtarinë e saj në kohën e duhur dhe në hollësi, përveç në rastet kur bie në kundërshtim me interesin publik apo privat.

Neni 181 E drejta e iniciativës

Këshilli Federal i paraqet projektet e legjislacionit të Asamblesë Federale në Asamblenë Federale.

Neni 182 Legjislacioni dhe zbatimi i tij

¹ Këshilli Federal nxjerr dispozita në formë të vendimeve dhe urdhërësave, në masën e lejuar nga Kushtetuta ose ligji.

² Ai siguron zbatimin e legjislacionit, dekreteve të Asamblesë Federale dhe aktgjyqimeve të dorëzuara nga autoritetet gjyqësore federale.

Neni 183 Financat

¹ Këshilli Federal harton planin financiar dhe projektbuxhetin si dhe përcakton llogaritë shtetërore.

² Ai siguron menaxhim të duhur financiar.

Neni 184 Marrëdhëniet me vendet e huaja

¹ Këshilli Federal është përgjegjës për punët e jashtme, në varësi të drejtës së pjesëmarrjes së Asamblesë Federale; ai përfaqëson Zvicrën jashtë vendit.

² Ai nënshkruan dhe ratifikon marrëveshje ndërkombëtare. Ai i paraqet ato pranë Asamblenë Federale për aprovim.

³ Kur kërkohet ruajtja e interesave të vendit, Këshilli Federal mund të lëshojë urdhra dhe të marrë vendimet e nevojshme. Urdhërat duhet të jenë të kufizuara në kohë.

Neni 185 Siguria e jashtme dhe e brendëshme

¹ Këshilli Federal merr masa për të ruajtur sigurinë e jashtme, pavarësinë dhe neutralitetin e Zvicrës.

² Ai merr masa për të ruajtur sigurinë e brendshme.

³ Duke u mbështetur drejtpërsëdrejti në këtë Nen ai mund të lëshojë urdhëresa dhe të marrë vendime për të parandaluar shqetësimet ekzistuese ose të afërta të përçarjes që rrezikojnë seriozisht rendin publik, sigurinë e jashtme ose sigurinë e brendshme. Këta urdhra duhet të jenë të kufizuara në kohë.

⁴ Në raste urgjente, ai mund të mbledhë trupa. Nëse mbledhë më shumë se 4.000 trupa ushtarakë për shërbim aktiv, ose nëse ky angazhim zgjat më shumë se tre javë, Asambleja Federale duhet të mbledhet pa vonesë.

Neni 186 Marrëdhëniet midis Konfederatës dhe Kantoneve

¹ Këshilli Federal është përgjegjës për marrëdhëniet midis Konfederatës dhe Kantoneve dhe bashkëpunon me ta.

² Miraton aktet legjislativ të Kantoneve, kur kjo kërkohet me ligj federal.

³ Ai mund të kundërshtoj marrëveshjet që Kantonet synojnë të lidhin midis tyre ose me komunitetet e huaja.

⁴ Ai siguron respektimin e legjislacionit federal, Kushtetutave dhe marrëveshjeve kantonale, dhe merr masat e nevojshme për përmbushjen e këtij funksioni.

Neni 187 Detyrat dhe kompetencat e tjera

¹ Këshilli Federal ka gjithashtu këto detyra dhe kompetenca:

- a. të mbikëqyrë administratën federale dhe organet ose personat e tjerë të ngarkuar me detyrat e Konfederatës;
- b. të raportojë rregullisht mbi menaxhimin e punëve të tij dhe gjendjen e vendit në Asamblenë Federale;
- c. të bëjë emërimet dhe zgjedhjet që nuk janë nën një autoritet tjetër;
- d. të trajtojë ankesat, në masën që parashikon ligji.

² Ligji mund t'i japë Këshillit Federal detyra dhe kompetencat e tjera.

Kapitulli 4¹⁰³ Gjykata supreme federale dhe autoritetet gjyqësore

Neni 188 Roli i Gjykatës Supreme Federale

¹ Gjykata Supreme Federale është autoriteti suprem gjyqësor i Konfederatës.

² Ligji rregullon organizimin dhe procedurat e saj.

³ Tribunali Federal ka administratën e vet.

Neni 189 Juridiksioni i Gjykatës Supreme të Federatës

¹ Gjykata Supreme Federale shqyrton shkeljet në lidhje me:

- a. të drejtën federale;
- b. të drejtën ndërkombëtare;
- c. të drejtën ndër-kantonale;
- d. të drejtat kushtetuese kantonale;
- e. autonominë e Komunave dhe garancitë e tjera kanonale për korporatat publike;
- f. të drejtat politike federale dhe kantonale.

¹⁰³ Pranuar me votim popullor të datës 12 mars 2000, hyn në fuqi nga data 1 janar 2007 (Dekreti Federal i datës 8 tetor 1999, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2000; DF i datës 8 mars 2005; RO 2002 3148; 2006 1059, FF 1997 I, 1999 7831; 2000 2814, 2001 4000).

Ibis ...¹⁰⁴

² Zgjedh mosmarrëveshjet midis Konfederatës dhe Kantoneve ose midis Kantoneve.

³ Me ligj mund të parashihen kompetenca tjera për Gjykatën Supreme Federale.

⁴ Vendimet e Asamblesë Federale dhe Këshillit Federal nuk mund të paraqiten për shqyrtim në Gjykatën Supreme Federale. Përrjashtimet përcaktohen me ligj.

Neni 190 E drejta e zbatueshme

Gjykata Supreme Federale dhe autoritetet e tjera gjyqësore zbatojnë ligjet federale dhe të drejtën ndërkombëtare¹⁰⁵.

Neni 191 Qasja në Gjykatën Supreme Federale

¹ Qasja në Gjykatën Supreme Federale është e garantuar me ligj.

² Për mosmarrëveshjet që nuk kanë të bëjnë me çështje ligjore parimore, ligji mund të parashikojë një vlerë minimale kontestuese.

³ Me ligj mund të përjashtohet qasja në Gjykatën Supreme Federale për fusha të caktuara.

⁴ Ligji mund të parashikojë një procedurë të thjeshtësuar për çështjet që janë qartazi të pa bazuara.

Neni 191a¹⁰⁶ Autoritetet të tjera gjyqësore të Konfederatës

¹ Konfederata do të krijoj një gjykatë penale; e cila shqyrton rastet penale të shkallës së parë që me ligj i nënshtrohen juridiksionit federal. Me ligj mund të parashihen kompetenca të tjera për gjykatën federale penale.

² Konfederata do të themeloj autoritetet gjyqësore për të shqyrtuar kontestet nga e drejta publike që bien nën juridiksionin e administratës federale.

³ Ligji mund të krijojë autoritete tjera gjyqësore të Konfederatës.

Neni 191b Autoritetet gjyqësore kantonale

¹ Kantonet do të caktojnë autoritetet gjyqësore për të gjykuar kontestet civile dhe publike, si dhe rastet penale.

² Ato mund të themelojnë autoritete të përbashkëta gjyqësore.

Neni 191c Pavarësia e autoriteteve gjyqësore

Autoritetet gjyqësore janë të pavarura në ushtrimin e kompetencave të tyre juridike dhe i nënshtrohen vetëm ligjit.

¹⁰⁴ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2003 (Dekreti Federal i datës 4 tetor 2002, Dekreti i Këshillit Federal i datës 25 mars 2003; RO 2003 1949; FF 2001 4590 5783, 2002 6026, 2003 2784). Shfuqizuar me votim popullor të dates 27 shtator 2009 (Dekreti Federal i dates 19 dhjetor 2008, Dekreti i Këshillit Federal i datës 1 dhjetor 2009; RO 2009 6409; FF 2008 2549 2565, 2009 19 7889). Duke u bazuar në Dekretin Federal të dates 4 tetor 2002 nuk është fuqizuar asnjëherë.

¹⁰⁵ Përmirësuar nga Komisioni hartues i Asamblesë Federale (Neni 58, par. 1, e LP; RS 171.10).

¹⁰⁶ Panuar me votim popullor të datës 12 mars 2000, hyn në fuqi për paragrafin 1 nga data 1 Prill 2003 dhe për paragrafët 2 dhe 3 nga data 1 shtator 2005 (Dekreti Federal i datës 8 tetor 1999, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2000; DKF i dates 24 shtator 2002; DKF i dates 2 mars 2005; RO 2002 3148, 2005 1475; FF 1997 I 1, 1999 7831, 2000 2814, 2001 4000, 2004 4481).

Titulli 6 Rishikimi i Kushtetutës dhe Dispozitat Kalimtare

Kapitulli 1 Rishikimi

Neni 192 Parimet

¹ Kushtetuta federale mund të rishikohet në çdo kohë, tërësisht ose pjesërisht.

² Kur Kushtetuta dhe legjislacioni që rezulton nuk parashohin ndryshe, rishikimi duhet të jetë në përputhje me procedurën legjislative.

Neni 193 Rishikimi i përgjithshëm

¹ Rishikimi i plotë i Kushtetutës mund të propozohet nga Populli ose nga njëri prej dy këshillave, ose me dekret nga Asambleja Federale.

² Nëse iniciativa vjen nga Populli ose në rast mosmarrëveshje midis dy këshillave, Populli vendos nëse duhet të bëhet rishikimi i plotë.

³ Nëse Populli voton për një rishikim të plotë, të dy këshillat do të rizgjedhen.

⁴ Rregullat me karakter të përgjithshëm të drejtës ndërkombëtare nuk mund të shkelen.

Neni 194 Rishikimi i pjesshëm

¹ Një rishikim i pjesshëm i Kushtetutës mund të kërkohet nga Populli ose të dekretohet nga Asambleja Federale.

² Çdo rishikim i pjesshëm duhet të respektojë parimin e kohezionit të çështjes; ai nuk mund të shkelë rregullat me karakter të përgjithshëm të drejtës ndërkombëtare.

³ Çdo iniciativë popullore për rishikimin e pjesshëm të Kushtetutës duhet të respektojë gjithashtu parimin e qëndrueshmërisë së formës.

Neni 195 Hyrja në fuqi

Kushtetuta e rishikuar hyn në fuqi plotësisht ose pjesërisht sapo Populli dhe Kantonet t'a kenë pranuar atë.

Kapitulli 2 Dispozitat kalimtare

Neni 196 Dispozita kalimtare në kuptimin e Dekretit Federal të 18 dhjetorit 1998 mbi Kushtetutën e re Federale

1. Dispozita kalimtare e Nenit 84 (tranziti Transalpin)¹⁰⁷

Trafiku i transitit të mallrave duhet të ketë kaluar nga rruga në hekurudhë brenda 10 vjetëve nga data kur është miratuar Iniciativa Popullore për Mbrojtjen e Rajoneve Alpine kundër Trafikut Tranzit.

¹⁰⁷ Panuar me votim popullor të datës 3 mars 2002, hyn në fuqi nga data 3 mars 2002 (Dekreti Federal i datës 5 tetor 2001, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 prill 2002; RO 2002 885; FF 2000 2346, 2001 1117 5473, 2002 3452).

2. *Dispozita kalimtare e Nenit 85 (Tarifa mbi qarkullimin e automjeteve të mallrave të rënda)*

¹ Konfederata do të vjelë një taksë vjetore për automjetet dhe rimorkiot e regjistruara në Zvicër ose jashtë saj, pesha e përgjithshme e të cilave për secilën prej këtyre dy kategorive të automjeteve është më e madhe se 3.5 ton për shfrytëzimin e rrugëve e hapur për trafikun e përgjithshëm.

² Kjo tarifë arrinë në:

a. për kamionë dhe automjete të artikuluar me tonazh

	Fr.
- më shumë se 3,5 t dhe më pak se ose i barabartë me 12 t	650
- më shumë se 12 ton dhe më pak se ose e barabartë me 18 t	2000
- më shumë se 18 t dhe më e vogël se ose e barabartë me 26 t	3000
- më shumë se 26 t	4000

b. për rimorkiot me tonazh

	Fr.
- më shumë se 3.5 t dhe më pak se ose i barabartë me 8 t	650
- më shumë se 8 t dhe më pak se ose e barabartë me 10 t	1500
- më shumë se se 10 t	2000

c. për autobusë

Fr.
650

³ Normat nga kjo tarifë mund të rregullohen nga akt federal deri në masën që kostoja e trafikut rrugor e justifikon atë.

⁴ Përveç kësaj, Këshilli Federal me urdhëresë, mund të përshtatë normat e taksës, të aplikueshme për kategorinë mbi 12 ton, të përmendur në par. 2, sipas ndryshimeve të mundshme të kategorive të peshave të përcaktuara në ligjin e 19 dhjetorit 1958 mbi trafikun rrugor¹⁰⁸.

⁵ Për mjetet që nuk janë vënë në qarkullim në Zvicër për një pjesë të vitit, Këshilli Federal përcakton normat e tarifës sipas kësaj periudhe; ai merr në konsideratë koston e perceptimit.

⁶ Këshilli Federal rregullon ekzekutimin. Ai mund të përcaktojë rregulla të veçanta për klasat e automjeteve të veçanta shumat e përshkruara në par. 2, të përjashtojë disa automjete nga ngarkesa dhe të krijojë, veçanërisht për udhëtimet në zonat kufitare. Këto rregulla nuk duhet të favorizojë

¹⁰⁸ RS 741.01

automjetet e regjistruara jashtë vendit në dëm të automjeteve zvicerane. Këshilli Federal mund të parashikojë gjoba në rast të shkeljes së tyre. Kantonet mbledhin tarifën për automjetet e regjistruara në Zvicër.

7 Ligji mund të kufizoj ose të shfuqizoj mbledhjen e kësaj tarife.

8 Kjo dispozitë ka efekt deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të 19 dhjetorit 1997 mbi tarifën për qarkullimin e automjeteve të rënda¹⁰⁹.

3. *Dispozitat kalimtare të Nenit 86 (Përdorimi i tarifave për detyra dhe shpenzimet në lidhje me transportin rrugor rrugor), dhe Nenit 87 (hekurudhat dhe transportet tjera) dhe Nenit 87a (Infrastruktura hekurudhore)*¹¹⁰

¹ Projektet kryesore hekurudhore përfshijnë linjën e re hekurudhore përgjatë Alpeve (LRHA), HEKUR 2000, lidhjen e Zvicrës Lindore dhe Perëndimore në rrjetin Evropian të hekurudhave me shpejtësi të lartë si dhe përmirësimin e mbrojtjes nga zhurma përgjatë vijave hekurudhore nëpërmjet masave aktive dhe pasive.

² Deri në përfundimin e pagesës së interesit dhe shlyerjes së avanseve të bëra në fondin e përmendur në Nenin 87a, par. 2, mjetet e parashikuara në Nenin 86, par. 2, shkronja e, nuk do të kreditohet në fond në përputhje me Nenin 86, par. 2, por me financim të veçantë për trafikun rrugor sipas Nenit 86, par. 4.¹¹¹

^{2bis} Këshilli Federal mund të përdorë mjetet e përmendura në paragrafin 2 deri më 31 dhjetor 2018 për financimin e infrastrukturës hekurudhore, dhe më pas për shlyerjen dhe pagimin e avanseve të bëra në fondin e përmendur me Nenin 87a, par. 2. Mjetet llogariten në përputhje me Nenin 86, par. 2, shkronja e.¹¹²

^{2ter} Norma e referuar në Nenin 86, par. 2, shkronja f, zbatohet dy vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj dispozite. Përpara këtij afati, ajo arrin në 5%.¹¹³

³ Projektet kryesore hekurudhore të përmendura në paragrafin 1 financohen nga fondi sipas Nenit 87a, par. 2.¹¹⁴

⁴ Katër projektet kryesore hekurudhore të përmendura në para. 1 do të miratohen me akte federale. Nevoja për secilin projekt madhor duhet të jetë vendosur globalisht, sikurse progresi i planifikimit të tij. Në kuadër të projektit LRHA, fazat e ndryshme të ndërtimit duhet të përfshihen në ligjin përkatës federal. Asambleja Federale ndan fondet e nevojshme përmes ndarjeve dhe zotimeve. Këshilli Federal miraton fazat e ndërtimit dhe përcakton afatet kohore.

¹⁰⁹ RS 641.81. Ligji ka hyrë në fuqi me datë 1 shkurt 2000.

¹¹⁰ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2017 (Dekreti Federal i datës 30 shtator 2016, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 prill 2017; RO **2017** 2643; FF **2015** 739 1253; **2017** 3213).

¹¹¹ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2017 (Dekreti Federal i datës 30 shtator 2016, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 prill 2017; RO **2017** 2643; FF **2015** 739 1253; **2017** 3213).

¹¹² Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2017 (Dekreti Federal i datës 30 shtator 2016, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 prill 2017; RO **2017** 2643; FF **2015** 739 1253; **2017** 3213).

¹¹³ Pranuar me votim popullor të datës 12 shkurt 2017, hyn në fuqi nga data 1 janar 2017 (Dekreti Federal i datës 30 shtator 2016, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 prill 2017; RO **2017** 2643; FF **2015** 739 1253; **2017** 3213).

¹¹⁴ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2014, hyn në fuqi nga data 1 janar 2016 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 maj 2014; DKF i datës 6 qershor 2014; RO **2015** 645; FF **2010** 6049 5225, **2012** 1371, **2013** 4191 5872, **2014** 3953 3957).

⁵ Kjo shifër është e zbatueshme deri në përfundimin e punëve ndërtimore dhe financimit (ripagimit të avanseve) të projekteve hekurudhore kryesore të përmendura në par. 1.

4. *Dispozita kalimtare e Nenit 90 (Energjia bërthamore)*

Deri më 23 Shtator të vitit 2000, nuk do të jepet asnjë leje të përgjithshme dhe asnjë leje për të ndërtuar, të filluar ose të përdorur objektet të reja për prodhimin e energjisë bërthamore.

5. *Dispozita kalimtare e Nenit 95 (Aktiviteti ekonomik me përfitim privat)*

Deri në miratimin e një legjislacioni, Kantonet janë të detyruara në njohjen e ndërsjelltë të kualifikimeve që vërtetojnë të trajnimet.

6. *Dispozita kalimtare e Nenit 102 (furnizimi i vendit)*

¹ Konfederata siguron furnizimin kombëtar me drithëra dhe miell për ngrënie.

² Kjo dispozitë kalimtare ka fuqi më së voni deri më 31 dhjetor 2003.

7. *Dispozita kalimtare e Nenit.103 (Politika Strukturore)*

Kantonet mund të vazhdojnë për të paktën edhe dhjetë vjet¹¹⁵, nga hyrja në fuqi e Kushtetutës, të mabjnë në fuqi rregulloret ekzistuese që kanë të bëjnë me hapjen e bizneseve të reja, me qëllim që të garantojë ekzistencën e pjesëve të rëndësishme të një industrie siç është hoteleria dhe restorantet.

8. ...¹¹⁶

9. *Dispozita kalimtare e Nenit 110, par. 3 (Dita e festës kombëtare)*

¹ Këshilli Federal rregullon hollësitë deri në hyrjen në fuqi të legjislacionit të ri federal.

² Dita e kombëtare e Zvicrës nuk llogaritet si pjesë e festave të përcaktuara me Nenin 18, par. 2, të Ligjit të Punës të 13 Marsit 1964.¹¹⁷

10. ...¹¹⁸

11. *Dispozita kalimtare e Nenit 113 (Skema pensionale profesionale)*

Personat e siguruar që i përkasin gjeneratës që punon në kohën e futjes së skemës pensionale profesionale dhe që për këtë arsye nuk kanë një periudhë të plotë kontributesh, duhet të marrin, përfitimet minimale ligjore sipas të ardhurave të tyre pas një periudhe kohore të së cilës varion nga dhjetë deri në njëzet vjet nga hyrja në fuqi e ligjit.

12. ...¹¹⁹

¹¹⁵ Lexo: «Kantonet mund të vazhdojnë përgjatë dhjetë vjet apo më shumë, që nga hyrja në fuqi...».

¹¹⁶ Neni 106 është rishikuar më datë 11mars 2012.

¹¹⁷ RS 822.11

¹¹⁸ Shfuqizuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, me efekt nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i datës 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035, 2005 883).

¹¹⁹ Neni 126 është rishikuar më 2 dhjetor 2001.

13.¹²⁰ *Dispozita kalimtare e Nenit 128 (Kohëzgjatja e vjeljes së tatimit)*

Tatimi i drejtpërdrejtë federal mund të aplikohet deri në fund të vitit 2020.

14.¹²¹ *Dispozita kalimtare e Nenit 130 (Tatimi mbi vlerën e shtuar)*¹²²

¹ Tatimi mbi vlerën e shtuar mund të mblidhet deri në fund të vitit 2020.

² Për të garantuar financimin e sigurimit të invalidor, Këshilli Federal rris normat e tatimit mbi vlerën e shtuar nga 1 janari 2011 deri më 31 dhjetor 2017 si në vijim: ...

³ Të ardhurat nga rritja të parashikuar në par. 2 do të ndahen plotësisht në Fondin e Kompensimit për Sigurimin e Aftësisë së Kufizuar.¹²³

⁴ Për të garantuar financimin e infrastrukturës hekurudhore, Këshilli Federal do të rris normat e përhapara me Nenin 25 të Ligjit të 12 Qershorit 2009¹²⁴ mbi TVSH-në nga 1 Janari 2018 deri më 31 dhjetor 2030, me kusht që afati kohor i përmendur në par. 1 të zgjatet.¹²⁵

⁵ Të gjitha të ardhurat nga rritja nga par. 4 është do të ndahen për fondin e përmendur në Nenin 87a.¹²⁶

15. *Dispozita kalimtare e Nenit 131 (Tatimi në birrë)*

Taksat e birrës do të vjelen sipas ligjit në fuqi deri në miratimin e një ligji të ri federal.¹²⁷

16. ...¹²⁸

¹²⁰ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

¹²¹ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

¹²² Pranuar me votim popullor të datës 26 shtator 2009, hyn në fuqi nga data 1 janar 2011 (Dekreti Federal i datës 13 qershor 2008 dhe i dates 12 qershor 2009, DKF i datës 7 shtator 2010; RO **2010** 3821; FF **2005** 4377, **2008** 4745, **2009** 3893 3899 3901 7889).

¹²³ Pranuar me votim popullor të datës 26 shtator 2009, hyn në fuqi nga data 1 janar 2011 (Dekreti Federal i datës 13 qershor 2008 dhe i dates 12 qershor 2009, DKF i datës 7 shtator 2010; RO **2010** 3821; FF **2005** 4377, **2008** 4745, **2009** 3893 3899 3901 7889).

¹²⁴ RS **641.20**

¹²⁵ Pranuar me votim popullor të datës 9 nëntor 2014, hyn në fuqi nga data 1 janar 2016 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2013, DKF i datës 13 maj 2014; DKF i datës 2 qershor 2014; DKF i datës 6 qershor 2014; RO **2015** 645; FF **2010** 6049, **2012** 1371, **2013** 4191 5872, **2014** 3953 3957).

¹²⁶ Pranuar me votim popullor të datës 9 nëntor 2014, hyn në fuqi nga data 1 janar 2016 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2013, DKF i datës 13 maj 2014; DKF i datës 2 qershor 2014; DKF i datës 6 qershor 2014; RO **2015** 645; FF **2010** 6049, **2012** 1371, **2013** 4191 5872, **2014** 3953 3957).

¹²⁷ RS **641.411**. Ligji i datës 6 tetor 2006 për taksën mbi birrën ka hyr në fuqi më 1 korrik 2007.

¹²⁸ Shfuqizuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, me efekt nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DF i datës 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035, **2005** 883).

Neni 197¹²⁹ Dispozitat kalimtare pas miratimit të Kushtetutës i 18 prillit 1999

1. *Hyrja e Zvicrës në Kombet e Bashkuara*

¹ Zvicra do t'i bashkohet me Organizatës së Kombeve e Bashkuara.

² Këshilli Federal autorizohet që t'i dërgojë Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së një kërkesë për pranimit të Zvicrës dhe një deklaratë të pranimit të detyrimeve që dalin nga Karta e Kombeve të Bashkuara.¹³⁰

2.¹³¹ *Dispozita kalimtare e Nenit 62 (Arsimi publik)*

Me hyrjen në fuqi të Dekretit Federal të 3 tetorit 2003 mbi reformën e barazisë financiare dhe ndarjen e detyrave midis Konfederatës dhe Kantoneve¹³², Kantonet, deri në miratimin e strategjive të tyre për nevoja të veçanta, por për një minimum prej tre vjetësh, do të marrin përfitimet e tanishme nga sigurimit të invalidor në lidhje me trajnim të veçantë shkollor (duke përfshirë edukimin e hershëm arsimor-terapeutik sipas Nenit 19 të Ligjit të 19 qershorit 1959 mbi sigurimin e personave me aftësi të kufizuara¹³³).

3. *Dispozita kalimtare e Nenit 83 (Autostradat Kombëtare)*

Kantonet e kompletojnë rrjetin e rrugëve nacionale të klasifikuara në Dekretin Federal të 21 qershorit 1960 për rrjetin e rrugëve kombëtare¹³⁴ (që nga hyrja në fuqi e DF të 3 tetorit 2003 lidhur me reformën e barazimit financiar dhe ndarjes së detyrave midis Konfederatës dhe Kantoneve¹³⁵) sipas direktivave të Konfederatës dhe nën mbikëqyrjen e saj strikte. Shpenzimet mbulohen nga Konfederata dhe Kantonet. Kontributi i Kantoneve për financimin e punëve varet nga ngarkesa e rrugëve kombëtare, dobia që ata përfaqësojnë dhe kapaciteti financiar i Kantoneve.

4.¹³⁶ *Dispozita kalimtare e Nenit 112b (Inkurajimi i integritetit të personave me aftësi të kufizuara)*

Me hyrjen në fuqi të Dekretit Federal të 3 tetorit 2003 mbi reformën e barazisë financiare dhe shpërndarjen e detyrave midis Konfederatës dhe Kantoneve¹³⁷, Kantonet marrin përfitimet e

¹²⁹ Neni 83 ka një përmbajtje të re. Panuar me votim popullor të datës 3 mars 2002, hyn në fuqi nga data 3 mars 2002 (Dekreti Federal i datës 5 tetor 2001, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 prill 2002; RO 2002 885; FF 2000 2346, 2001 1117 5473, 2002 3452).

¹³⁰ RS 0.120

¹³¹ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

¹³² RO 2007 5765

¹³³ RS 831.20

¹³⁴ RS 725.113.11

¹³⁵ RO 2007 5765

¹³⁶ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i dates 7 nëntor 2007; RO 2007 5765; FF 2002 2155, 2003 6035; 2005 883).

¹³⁷ RO 2007 5765

tanishme të sigurimit të invaliditetit për institucionet, punëtoritë dhe shtëpitë e banimit derisa të kenë të miratuar strategjitë e tyre për personat me aftësi të kufizuara, e cila gjithashtu përfshin dhënien e kontributeve kantonale për kostot e ndërtimit dhe të operimit të institucioneve të banorëve nga Kantoni, për të paktën për tre vjet.

5.¹³⁸ *Dispozita kalimtare e Nenit 112c (Ndhima për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara)*

Kantonet do të vazhdojnë të ndajnë mjete për organizatat që ofrojnë kujdes në shtëpi për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara që aktualisht janë paraparë me Nenin 101bis të Ligjit federal të 20 dhjetorit 1946 për sigurimin e pleqërisë dhe të bashkëshortëve mbijetues¹³⁹, derisa ato të nxjerrin rregullore mbi këtë fushë.

7.¹⁴⁰ *Dispozitat kalimtare e Nenit 120 (Inxhinieria gjenetike në domenin jo-njerëzor)*

Bujqësia zvicerane nuk përdor organizma të modifikuara gjenetikisht për pesë vjet pas miratimit të kësaj dispozite kushtetuese. Në veçanti, ato nuk mund të importohen ose të vendosen në qarkullim:

- a. bimë të modifikuara gjenetikisht, pjesë të bimëve dhe farërave që janë në gjendje të riprodhohen dhe janë të destinuara për përdorim në mjedis për qëllime bujqësore, hortikulturore ose pyjore;
- b. kafshë të modifikuara gjenetikisht për prodhimin e ushqimit dhe produkteve të tjera bujqësore.

8.¹⁴¹ *Dispozita kalimtare e Nenit 121 (Qëndrimi dhe statusi të të huajve)*

Në pesë vitet pas pranimit të Nenit 121, par. 3 deri në 6 nga Populli dhe Kantonet, ligjvënësi përcakton shkeljet që përbëjnë veprat penale sipas Nenit 121, par. 3, i plotëson ato dhe nxjerr dispozitat penale që kanë të bëjnë me hyrjen e paligjshme në territorin e përmendur në Nenin 121, par. 6.

9.¹⁴² *Dispozita kalimtare e Nenit 75b (Shtëpitë e dyta)*

¹³⁸ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2004, hyn në fuqi nga data 1 janar 2008 (Dekreti Federal i datës 3 tetor 2003, Dekreti i Këshillit Federal i datës 26 janar 2005; DKF i datës 7 nëntor 2007; RO **2007** 5765; FF **2002** 2155, **2003** 6035; **2005** 883).

¹³⁹ RS **831.10**

¹⁴⁰ Pranuar me votim popullor të datës 27 nëntor 2005, hyn në fuqi nga data 27 nëntor 2005 (Dekreti Federal i datës 17 qershor 2005, Dekreti i Këshillit Federal i datës 29 janar 2006; RO **2006** 89; FF **2003** 6327, **2004** 4629; **2005** 3823, **2006** 1037).

¹⁴¹ Pranuar me votim popullor të datës 28 nëntor 2010, hyn në fuqi nga data 28 nëntor 2010 (Dekreti Federal i datës 28 qershor 2010, Dekreti i Këshillit Federal i datës 17 maj 2011; RO **2011** 1199; FF **2008** 1745, **2009** 4571, **2010** 3853, **2011** 2593).

¹⁴² Pranuar me votim popullor të datës 11 mars 2012, hyn në fuqi nga data 11 mars 2012 (Dekreti Federal i datës 17 qershor 2011, Dekreti i Këshillit Federal i datës 20 qershor 2012; RO **2012** 3627; FF **2008** 1003 7891, **2011** 4473, **2012** 6149).

¹ Këshilli Federal me urdhëresë do të nxjerrë dispozitat e nevojshme lidhur me ndërtimin, shitjen dhe regjistrimin në regjistrin e tokave, nëse legjislacioni përkatës nuk ka hyrë në fuqi dy vjet pas pranimi të Nenit 75b nga Populli dhe Kantonet.

² Lejet e nërtimit për shtëpi të dyta që janë lëshuar mes 1 janarit të vitit pas pranimi të Nenit 75b nga Populli dhe Kanonet dhe datës së hyrjes në fuqi të dispozitave të tij të zbatimit do të jenë të pavlefshme.

10.¹⁴³ Dispozita kalimtare e Nenit 95, par. 3

Deri në hyrjen në fuqi të dispozitave ligjore, Këshilli Federal do të nxjerrë dispozitat e nevojshme zbatuese, brenda një viti pas pranimi të Nenit 95, par. 3, nga Populli dhe Kanonet.

11.¹⁴⁴ Dispozitat kalimtare e Nenit 121a (Menaxhimi i Imigracionit)

¹ Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë lidhur në kundërshtim me Nenin 121a duhet të rinegociohen dhe të përshtaten brenda tre vjetëve nga pranimi i tij nga Populli dhe Kantonet.

² Nëse ligjet përkatëse të zbatimit nuk kanë hyrë në fuqi brenda tre vjetësh nga pranimi i Nenit 121a nga ana e Popullit dhe Kantoneve, Këshilli Federal me urdhër do nxjerr dispozitat e përkohshme të nevojshme për zbatim.

Data e hyrjes në fuqi: 1 janar 2000¹⁴⁵

Dispozitat përfundimtare të Dekretit Federal të 18 Dhjetorit 1998

II

¹ Shfuqizohet Kushtetuta Federale e Konfederatës Zvicerane e 29 majit 1874.

² Dispozitat e mëposhtme kushtetuese, të cilat duhet të konvertohen në dispozita ligjore, mbeten të zbatueshme deri në hyrjen në fuqi të këtyre dispozitave:

a. Neni 32^{quater}, par. 6

Ndalohet shitja e pijeve alkoolike.

b. Neni 36^{quinquies}, par. 1, fjalia 1, fjalia e parafundit dhe fjalia 4

¹⁴³ Pranuar me votim popullor të datës 3 mars 2013, hyn në fuqi nga data 3 mars 2013 (Dekretet e Këshillit Federal të datave 15 nëntor 2012 dhe 30 prill 2013; RO 2013 1303; FF 2006 8319, 2008 2325, 2009 265, 2012 8503, 2013 2759).

¹⁴⁴ Pranuar me votim popullor të datës 9 shkurt 2014, hyn në fuqi nga data 1 janar 2016 (Dekreti Federal i datës 20 qershor 2013, Dekreti i Këshillit Federal i datës 13 maj 2014; DKF i dates 6 qershor 2014; RO 2015 645; FF 2010 6049 5225, 2012 1371, 2013 4191 5872, 2014 3953 3957).

¹⁴⁵ DF i datës 28 shtator 1999 (RO 1999 2555; FF 1999 7145)

¹ Për përdorimin e rrugëve kombëtare të klasës së parë dhe të dytë, Konfederata vjelë një tarifë vjetore prej 40 frangash për automjetet dhe rimorkiot e regjistruara në Zvicër ose jashtë saj, pesha e përgjithshme e të cilave nuk kalon 3,5 t për secilën prej këtyre dy kategorive të automjeteve. ...

² ... Këshilli Federal mund të përjashtojë disa automjete nga tarifa dhe të nxjerr rregulla të veçanta për udhëtimet e bëra në zonat kufitare. Ajo nuk duhet të favorizojë automjetet e regjistruara jashtë vendit në dëm të automjeteve zvicerane. Këshilli Federal mund të parashikojë gjoba në rast të shkeljes. Kantonet duhet të mbledhin taksën mbi automjetet e regjistruara në Zvicër dhe të monitorojnë përputhshmërinë me të gjitha automjeteve me rregulloret.

⁴ ... Me ligj federal pagesa e taksës mund të shtrihet edhe për kategoritë e tjera të automjeteve të cilat nuk i nënshtrohen taksës për atutomjete të peshave të rënda.

c. Neni 121^{bis}, par. 1, 2 dhe 3, fjalitë 1 dhe 2

¹ Kur Asambleja Federale përgatit një kundër-propozim, tre pyetje do t'i dorëzohen votuesve në të njëjtën fletëvotim. Çdo votues mund të deklarojë pa rezerva:

1. nëse preferon iniciativën popullore për ligjin në fuqi;
2. nëse ai preferon kundërprojektin për ligjin fuqi;
3. cili nga të dy tekstet duhet të hyjë në fuqi në rast se Populli dhe Kantonet preferojnë të dy tekstet në regjimin në fuqi.

² Shumica absolute përcaktohet veçmas për secilën pyetje. Pyetjet pa përgjigje nuk merren në konsideratë.

³ Kur të dyja iniciativa popullore dhe kundërprojekti pranohen, rezultati i pyetjes së tretë do të jetë vendimtar. Propozimi që merr numrin më madh të votave në pyetje nga Populli dhe Kantonet do të hyjë në fuqi.

III

Asambleja Federale do të përshtasë ndryshimet në Kushtetutën Federale të 29 majit 1874 në Kushtetutën e re Federale. Dekreti i lëshuar për këtë qëllim nuk është subjekt i referendumit.

IV

¹ Ky dekret i dorëzohet për votim Popullit dhe Kantoneve.

² Asambleja Federale përcakton datën e hyrjes në fuqi.

Përmbajtja

Preambula	1
Titulli 1 Dispozitat e përgjithshme	1
Titulli 2 Të drejtat themelore, shtetësia dhe qëllimet shoqërore	2
Kapitulli 1 Të drejtat themelore	2
Kapitulli 2 Shtetësia, dhe të drejtat politike	7
Kapitulli 3 Qëllimet sociale	7
Titulli 3 Konfederata, Kantonet dhe Komunat	8
Kapitulli 1 Marrëdhëniet në mes të Konderatës dhe Kantoneve	8
Seksioni 1 Detyrat e Konfederatës dhe Kantoneve	8
Seksioni 2 Bashkëpunimi në mes të Konfederatës dhe Kantoneve.....	9
Seksioni 3 Komunat	11
Seksioni 4 Garancitë federale.....	11
Kapitulli 2 Kompetencat	11
Seksioni 1 Marrëdhëniet me jashtë	11
Seksioni 2 Siguria, mbrojtja kombëtare, mbrojtja civile.....	12
Seksioni 3 Arsimi, hulumtimi shkencor dhe kultura.....	13
Seksioni 4 Mjedisi dhe planifikimi hapsinor.....	17
Seksioni 5 Punët publike dhe transporti	20
Seksioni 6 Energjia dhe komunikimi	23
Seksioni 7 Ekonomia.....	24
Seksioni 8 Banimi, puna, Sigurimi social dhe Shëndetësia	29
Seksioni 9 Vendqëndrimi dhe statusi e të huajve.....	35
Seksioni 10 E drejta civile, e drejta penale, metrologjia	36
Kapitulli 3 Sistemi i financave	37
Titulli 4 Populli dhe Kantonet	41
Kapitulli 1 Dispozitat e përgjithshme	41
Kapitulli 2 Iniciativa popullore dhe referendumi	41
Titulli 5 Autoritetet federale	44
Kapitulli 1 Dispozitat e përgjithshme	44
Kapitulli 2 Asamblea federale	45
Seksioni 1 Organizimi.....	45

Seksioni 2	Procedura	46
Seksioni 3	Kompetencat	47
Kapitulli 3	Këshilli federal dhe administrata federale	50
Seksioni 1	Organizimi dhe procedurat	50
Seksioni 2	Kompetencat	51
Kapitulli 4	Gjykata supreme federale dhe autoritetet gjyqësore	52
Titulli 6	Rishikimi i Kushtetutës dhe Dispozitat Kalimtare	54
Kapitulli 1	Rishikimi	54
Kapitulli 2	Dispozitat kalimtare	54